



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 9 (827813)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 3 mars 2023

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Të gjitha së bashku në rritjen e rolit të femrës në FA

Në kuadër të zbatimit të "Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore në FA 2022-2030", miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 651, datë 06.05.2022 dhe VKM-së nr. 400, datë 30.6.2021 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030 dhe të planit të saj të veprimit", zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu zhvilloi një takim me gratë dhe vajzat ushtarake e civile të Batalionit të parë të Forcës Tokësore,

dislokuar në Vaun e Dejës. Qëllimi i takimit ishte njohja me punën që bëhet për zbatimin e Rezolutës 1325 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Mbi Gruan, Paqen dhe Sigurinë", "Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore në FA 2022-2030", "Politikat dhe procedurat për eliminimin e dhunës, dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës të strukturave të Ministrisë Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura" dhe dokumente e tjera, dalë për këtë qëllim në shkallë kombëtare dhe nga Ministria e

Mbrojtjes. Nëpërmjet takimit të lirë me femrat ushtarake për të diskutuar e ndarë me to mendime e probleme të punës së përditshme me qëllim rritjen e rolit të femrës në realizimin me sukses të detyrave në pozicionet e tyre të punës. Gjeneralmajor Manushaqe Shehu u prit sipas rregullit ceremonial me truproje nga komandanti batalionit, nënkolonel Ali Mali dhe pasi mori një raport të shkurtër të punës në përgjithësi që... »» faqe 3



Peleshi: Së bashku për mbrojtjen e paqes dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor



Gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim ambasadorin e Austrisë, sh.t. z. Christian Steiner

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në një takim kortezie ambasadorin e Austrisë në vendin tonë, sh.t. z. Christian Steiner, i cili shoqërohej nga zëvendës atasheu ushtarak, kolonel Bernd Skaza, rezident në Greqi.



Gjeneral brigade Kingji falënderoi z. Steiner për vëmendjen e veçantë që Austria ka ndaj Shqipërisë, në mbështetjen e pakushtëzuar në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, si rrjedhojë e lidhjeve të hershme politike, ekonomike dhe gjeo-strategjike, me rajonin ku bëjmë pjesë...

»» Faqe 2

Stërvitje e përbashkët mes Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare spanjolle

Në ishullin e Sazanit u zhvillua një stërvitje e përbashkët midis Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare spanjolle. Në stërvitje morën pjesë anijet spanjolle L-61 "Juan Carlos I", një anije shumë-rolesh zbarkuese, dy avionë F-18 nga aeroplanmbajtësja amerikane "G. W. Bush" dhe fregata spanjolle F-103 "Blas de Lezo". Nga Forca Detare morën pjesë anijet e Grupit të Parë Patrullues P-132 Oriku, P-134 Butrinti si dhe efektivë të Grupit të Bordingut. Gjatë stërvitjes "MisEx 830" u zhvilluan manovra të thjeshta taktike, formacione...



»» Faqe 6

Ekspertë nga Brukseli, trajnim për emergjencat në Tiranë

Një grup ekspertësh të DG-Echos nga Brukseli ndodhen në Tiranë, për të marrë pjesë në një workshop dyditor, të organizuar nga AKMC dhe në bashkëpunim me strukturat operacionale, ministritë e linjës, dy prefekturat, Agjencinë Shtetërore të Informacionit dhe Gjeohapësirës, Institutin e Gjeoshkencës, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, si dhe agjenci të tjera, që kanë rolin e tyre në Mbrojtjen Civile. Ky bashkëpunim vjen pak kohë pas anëtarësimit të Shqipërisë në Mekanizmin Evropian të Mbrojtjes Civile. Në fjalën e tij...



»» Faqe 9

Peleshi: Së bashku për mbrojtjen e paqes dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor

Qeveria Shqiptare mbajti mbledhjen e përbashkët me qeverinë e Malit të Zi, ku u nënshkruan 11 marrëveshje mes dy vendeve në fushën e energjisë, mbrojtjes, infrastrukturës, ekonomisë e rinisë etj.

Të dy qeveritë nënshkruan 11 marrëveshje. E dyta mbledhje e përbashkët mes qeverisë së Malit të Zi dhe asaj shqiptare prodhoi edhe një sërë marrëveshjesh të tjera, siç ishte ajo e ministrit të mbrojtjes Niko Peleshi dhe homologut të tij malazez Filip Axhiq.

“Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit me Ministrinë e Mbrojtjes së Malit të Zi, një tjetër kontribut për forcimin e sigurisë rajonale dhe jo vetëm. Përpjekje të përbashkëta për mbrojtjen e paqes dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor”, - theksoi ministri Peleshi.

Nënshkrimi i projektit për ndërtimin e urës, e cila do ta kthejë këtë në një zonë të përbashkët turistike, pasi do të lidhë



Velipojën me pjesën tjetër të bregut në Malin e Zi. Në mbledhjen e qeverisë u nënshkrua edhe marrëveshja që do t'i hapë rrugë ndërtimit të pikës së re kufitare mes Shqipërisë dhe Malit

të Zi. Kjo pikë kufitare do të hapet pranë Ulqinit dhe Velipojës, në zonën midis Sveti Nikola (Mal i Zi) dhe Pulaj (Shqipëri) dhe do të lehtësojë lëvizjen e qytetarëve mes dy vendeve.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në një takim kortezie ambasadorin e Austrisë në vendin tonë, sh.t. z. Christian Steiner, i cili shoqërohej nga zëvendës atasheu ushtarak, kolonel Bernd Skaza, rezident në Greqi.

Gjeneral brigade Kingji falënderoi z. Steiner për vëmendjen e veçantë që Austria ka ndaj Shqipërisë, në mbështetjen e pakushtëzuar në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, si rrjedhojë e lidhjeve të hershme politike, ekonomike dhe gjeostrategjike, me rajonin ku bëjmë pjesë.

Takimi kishte në fokus bashkëpunimin ushtarak në fushën e logjistikës, trajnimet dhe arsimimin në shkollat austriake, si dhe shkëmbimin e eksperiencës në fushën e mbështetjes së forcave të dislokuara në misionet apo operacione jashtë vendit.

Një temë mjaft e rëndësishme ishte dhe diskutimi mbi mbrojtjen dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë, ku të dyja shtetet bashkëpunojnë ngushtë në OKB, si dy vende “anëtare jo të përhershme” në Këshillin e Sigurimit. Ambasadori Steiner e vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin ushtarak mes dy vendeve, si në nivelin politik ashtu edhe atë ushtarak. Ai u shpreh se mes dy vendeve tona mbeten ende shumë potenciale bashkëpunimi në fushën ekonomike, ushtarake, tregtare e kulturore që duhen shfrytëzuar, aktivitete për të cilat ambasada do të punojë fort në këtë drejtim.



Gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim ambasadorin e Austrisë, sh.t. z. Christian Steiner



GJENERAL BRIGADE KINGJI FALËNDEROI Z. STEINER PËR VËMENDJEN E VEÇANTË QË AUSTRIA KA NDAJ SHQIPËRISË, NË MBËSHTETJEN E PAKUSHTËZUAR NË PROCESIN E ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN, SI RRJEDHOJË E LIDHJEVE TË HERSHME POLITIKE, EKONOMIKE DHE GJEOSTRATEGJIKE, ME RAJONIN KU BËJMË PJESE.

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Të gjitha së bashku në rritjen e rolit të femrës në FA

Në kuadër të zbatimit të “Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore në FA 2022-2030”, miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 651, datë 06.05.2022 dhe VKM-së nr. 400, datë 30.06.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, 2021-2030 dhe të planit të saj të veprimit”, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu zhvilloi një takim me gratë dhe vajzat ushtarake e civile të Batalionit të parë të Forcës Tokësore, dislokuar në Vaun e Dejës.

Qëllimi i takimit ishte njohja me punën që bëhet për zbatimin e Rezolutës 1325 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Mbi Gruan, Paqen dhe Sigurinë”, “Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore në FA 2022-2030”, “Politikat dhe procedurat për eliminimin e dhunës, dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës të strukturave të Ministrisë Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura” dhe dokumente të tjera, dalë për këtë qëllim në shkallë kombëtare dhe nga Ministria e Mbrojtjes.

Nëpërmjet takimit të lirë me femrat ushtarake për të diskutuar e ndarë me to mendime e probleme të punës së përditshme me qëllim rritjen e rolit të femrës në realizimin me sukses të detyrave në pozicionet e tyre të punës. Gjeneralmajor Manushaqe Shehu u prit sipas rregullit ceremonial me truproje nga komandanti batalionit, nënkolonel Ali Mali dhe pasi mori një raport të shkurtër të punës në përgjithësi që bën batalioni për realizimin e detyrave të misionit dhe ato në ndihmë të popullsisë në raste emergjencash civile, si dhe njohjes me ambientet e kushtet e punës e të jetesës së efektivave, zhvilloi një takim të veçantë me femrat ushtarake e civile të batalionit.

Në fjalën e saj, gjeneralmajor Manushaqe Shehu u shpreh: ‘Jam e privilegjuar që, sot në cilësinë e zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, por edhe si femër, si grua, si motër dhe si nënë, të zhvilloj këtë takim me ju, ku të ndajmë mendime së bashku për rolin e femrës në FA, e në veçanti në këtë repart të rëndësishëm të Forcës Tokësore. Paraprakisht, gjej rastin të falënderoj zëvendëskomandantin e Forcës, gjeneral Dimon dhe komandantin e batalionit, nënkolonel Ali Malin për gatishmërinë e treguar për zhvillimin e këtij takimi me ju.

Qëllimi i këtij takimi ishte njohja me Rezolutën 1325 të Këshillit të Kombeve të Bashkuara “Mbi Gruan, Paqen dhe Sigurinë” dhe të gjitha dokumentet e tjera të dalë për këtë qëllim, si dhe ndarja e mendimeve dhe problemeve që hasin në punën e përditshme...

Këtë takim, gjeneralmajor Shehu e konsideroi një bashkëbisedim të lirë me koleget ushtarake e civile që punojnë në këtë batalion. Femra shqiptare, aq më tepër femrat ushtarake, por edhe ato civile që punojnë në Forcat e Armatosura, janë një forcë e vlerësuar në tërë jetën politike, ekonomike, arsimore, ushtarake e në shumë fusha të rëndësishme të jetës së vendit.

Shembujt e femrave që kanë bërë dhe bëjnë karrierë të suksesshme dhe mjaft të vlerësuar e të spikatur në jetën e vendit ka me qindra, ashtu siç ka edhe mjaft femra ushtarake po me karrierë të suksesshme, në çdo pozicion që i është dhënë mundësia të kontribuojnë në zhvillimin e Forcave të Armatosura.

Ajo falënderoi secilën femër të batalionit në veçanti për kontributin e dhënë dhe që vijojnë të japin.



Me tej, gjeneralmajor Shehu përgëzoi gjithë ato femra që punojnë në këtë batalion ku kryejnë detyra të rëndësishme të stërvitjes, shërbimit, të mbështetjes logjistike dhe direkt në nënrepartet operacionale. Ajo i përgëzoi për përkushtimin, sakrificat dhe përgjegjësitë që marrin përsipër, përkrah edhe kolegëve të tyre.

“Unë si Manushaqe edhe në detyrat e mëparshme që kam kryer, kam ndjekur në vazhdimësi problemin e zbatimit të rezolutës 1325 në FA. Për këtë kam marrë pjesë në shumë aktivitete brenda e jashtë vendit, ku kam ngritur me forcë zërin, që sot femrës ushtarake në FA t’i jepet me dinjitet vendi dhe roli që i takon.

Diçka më tepër për takimin e fundit, ku me iniciativë të presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, mora pjesë në Forumin Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë zhvilluar në Prishtinë. Forumi ndërkombëtar pati si qëllim reflektimin e punës mbi sukseset dhe sfidat e kësaj axhede, 22 vite pas miratimit të Rezolutës 1325 të OKB-së “Gruaja, Paqja dhe Siguria” si dhe rritjen e ndërgjegjësitimit mbi nevojën për të njohur e promovuar aftësitë e grave dhe vajzave për të kontribuar

në mënyrë aktive e përmbytësore në procese të paqes dhe sigurisë. Forumi u zhvillua në një kohë kur paqja, liria



dhe siguria po sulmohen në zemër të Evropës, teksa gratë e vajzat sërish janë në qendër të dhunës, torturës dhe trajtimit çnjerëzor.

Në panelin “Gratë në Sektorin e Sigurisë: Sfidimi i stereotipave gjinore në sektorin e sigurisë”, ku unë mora pjesë si zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, në fjalën time veç të tjerash dhashë përvojën e Forcave të Armatosura shqiptare në zbatimin



e Barazisë Gjinore, u ndala në Planin Kombëtar të Barazisë Gjinore dhe në Planin e Veprimit të Ministrisë së Mbrojtjes, hartuar në mbështetje të rezolutës 1325 të OKB-së “Gruaja, Paqja dhe Siguria”. Theksova me forcë se roli i femrës ushtarake është rritur ndjeshëm si në arsimim, trajnim, në promovim në detyra e gradë. Femrat ushtarake, sot i gjen në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në përfaqësitë tona në NATO, atashë ushtarake, në kryerjen e detyrave operacionale e mbështetëse brenda vendit, të barabarta me kolegët e tyre burra. Gjithashtu i njoha pjesëmarrësit në panel edhe me hartimin e dokumentit mjaft të rëndësishëm që lidhet me mbrojtjen e femrave ushtarake ndaj dhunës dhe ngacmimeve në pozicionin e punës, dokument i cili është përgatitur dy vite më parë, me asistencën e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri.

Të dashura gra e vajza ushtarake, por edhe civile të batalionit të parë! Ju tashmë jeni të njohura me Rezolutën 1325 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara: “Gruaja, Paqja dhe Siguria”, Planin Kombëtar dhe Planin e Ministrisë së Mbrojtjes në zbatim të kësaj rezolute. Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, unë kam qenë në krye të një grupi pune që ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rezolutës, ku pjesë e këtij grupi mund të ketë qenë edhe dikush prej jush që ndodheni sot në këtë takim. Sa për dijeni ish-ministret e Mbrojtjes, zonja Kodheli e zonja Xhaçka dhe aktualisht zoti Niko Peleshi kanë qenë dhe janë mbështetës kryesorë të këtij procesi. Gjithashtu dua të theksoj edhe mbështetjen që jep në këtë drejtim shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Arben Kingji, i cili miratoi planin e zhvillimit të takimeve me femrat ushtarake të Forcave të Armatosura, takim i cili filloi vitin e kaluar në komandën e Forcës Detare dhe sot jemi

pranë jush në Vaun e Dejës.

Aktualisht, në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe Planit të saj të Veprimit, miratuar me VKM nr.400, datë 30.06.2021, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 651, datë 06.05.2022 kemi të miratuar “Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2022-2030 në FA”, i cili është i hedhur në uebsaitin e MM. Në të dyja këto dokumente, që janë në zbatim dhe mbështetje të Rezolutës 1325, janë parashikuar një sërë masash, të cilat bëjnë të mundur mbështetjen dhe dhënien e rolit që i takon gruas në jetën ushtarake. Është detyrë e juaja për të kërkuar te komandantët dhe eprorët tuaj me forcë dhe kurajë zbatimin e tyre.”

Në fund gjenerale Shehu iu drejtua pjesëmarrësve femra se, “çilado nga ju mund të flasë e trajtojë çfarëdo problemi, pa asnjë ndrojtje”. Ato në fjalën e tyre falënderuan gjeneralen për këtë takim të ngrohtë e mjaft miqësor, duke theksuar se ky është takimi i parë me një gjenerale femër të FA-së. Në diskutimet e tyre në thelb kishin angazhimin e tyre për kryerjen e detyrave dhe rritjen e forcës së femrës në jetën ushtarake të repartit, por nga ana tjetër rritjen edhe të vëmendjes të strukturave eprore deri në Shtabin e Përgjithshëm për një trajtim në të ardhmen edhe më të mirë, sidomos në shtimin e kuotave të arsimimit e kualifikimit, por edhe të gradimeve të reja.

Në mbyllje të takimit gjenerale Shehu theksoi se: “Këto probleme mendova të ndaj me ju në këtë takim. Patjetër që ka edhe probleme të tjera. Le t’i japim të gjitha së bashku një shtytje të mëtejshme rritjes së rolit të femrës në FA.

Mua do të më kini kurdoherë, jo në ballë, që patjetër, se ma kërkon pozicionin e punës dhe grada që mbaj, por do të jem në krahun tuaj për çdo problem. Zyra ime, edhe pse jeni larg, do të jetë hapur për këdo nga ju!”



Kursi i Lartë i Oficerit zhvillon seminar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë

Në vijim të programit mësimor, kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit, nën drejtimin e departamentit të Udhëheqjes Ushtarake pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, zhvilluan seminar në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Tiranë. Stafi akademik dhe grupi mësimor u pritën nga dekan i Fakultetit prof. dr. Sabri Laci i shoqëruar nga prof. dr. Mark Marku dhe prof. asoc. dr. Alban Tartari, të cilët i uruan mirëseardhjen dhe i falënderuan pjesëmarrësit për vizitën.

Në vijim prof. asoc. dr. Alban Tartari realizoi një prezantim të zgjeruar me temë "Angazhimi me median dhe marrëdhëniet publike", duke u ndalur tek roli dhe angazhimet e strukturave ushtarake në fushën e Medias dhe Komunikimit Strategjik.

Kursantët treguan mjaft interes për temën dhe drejtuan pyetje mbi komunikimin në nivelin e lidershipit strategjik, tendencat e fundit të medias si dhe ndryshimet e pritshme në të ardhmen.

Vizita mësimore u mbyll me fjalën e shefit të departamentit, kolonel Mehmet Metko dhe dekanit, prof. dr. Sabri Laci, të cilët shprehën rëndësinë e realizimit të këtyre seminareve si pararendëse të bashkëpunimeve të ndryshme në të ardhmen mes Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë dhe Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.



KLO, vizitë në prefekturën e Korçës

25 efektivë (kursantë) të Kursit të Lartë të Oficerit, u pritën nga prefekti i qytetit të Korçës z. Nertil Jole, për t'u njohur me rolin dhe misionin e institucionit të Prefektit të Qarkut, bashkëpunimin me Forcat e Armatosura, si dhe institucione të tjera qendrore e vendore, në kuadër të aksioneve të ndryshme të zhvilluara në fushën e Mbrojtjes Civile.

Nga ana e tij, z. Jole iu shprehu urimit e tij, për suksese në rrugën e karrierës së tyre ushtarake, dhe vlerësimin për misionin e tyre të ndëruar, i cili meriton respektin e gjithë shoqërisë.



Specialistët EOD të Batalionit të Xhenios japin kontributin e tyre në eliminimin e municioneve të paplasura

Pas njoftimit nga autoritetet vendore të fshatit Shegan, bashkia Vorë, për konstatimin e një municioni luftarak, një grup prej 5 vetash, specialistë EOD të Batalionit të Xhenios në KM, shkuan menjëherë në vendngjarje.

Ata, në masa të larta sigurie, kryen kontrollin e vendit, ku konstatuan se municioni i zbuluar ishte një predhë artilerie ETH 77mm, prodhim italian.

Ky municion u vlerësua i sigurt për t'u transportuar, gjë që mundësoi lëvizjen dhe magazinimin e tij. Operacioni përfundoi me sukses.



Atashetë ushtarakë të vendeve të NATO-s dhe ai i Republikës së Kosovës, vizituan Regjimentin e Operacioneve Speciale (ROS).



Pas përfundimit me sukses të misionit 6-mujor, kontingjenti KFOR-2 i trupave komando të ROS, ia transferoi autoritetin kontingjentit KFOR-3 të batalionit të Dytë të Këmbëorisë. Në ceremoninë e zhvilluar në bazën "Camp Villaggio Italia", Pejë, Kosovë, kontingjentit KFOR-2 iu akorduan edhe medaljet NATO NON ARTICLE 5.



Forca Tokësore akordon certifikata mirënjohje, për personelin pjesëmarrës në misionin humanitar, për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti në Republikën e Turqisë.





Në ishullin e Sazanit u zhvillua një stërvitje e përbashkët midis Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare spanjolle. Në stërvitje morën pjesë anijet spanjolle L-61 "Juan Carlos I", një anije shumë-roleshe zbarkuese, dy avionë F-18 nga aeroplanmbajtësja amerikane "G. W. Bush" dhe fregata spanjolle F-103 "Blas de Lezo".

Nga Forca Detare morën pjesë anijet e Grupit të Parë Patrullues P-132 Oriku, P-134 Butrinti si dhe efektivë të Grupit të Bordingut.

Gjatë stërvitjes "MisEx 830" u zhvilluan manovra të thjeshta taktike, formacione të ndryshme si zhvillim të embargos detare, ku mjetet detare u mbështetën nga mjete ajrore.

Gjithashtu u krye operacion zbar-kimi i përbashkët detar dhe ajror me helikopter dhe gomone në ishullin e Sazanit sipas skenarit stërvitor për shpëtim dhe evakuim të efektivëve të rrëzuar në zonë armiqësore. U zhvilluan stërvitje SurfEx për mbrojtjen e komandës së Task Forcës nga sulme dhe mjete të ndryshme në zonë armiqësore.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte integrimi i kapaciteteve detare dhe ajrore për evakuim të personelit në zonë të rrezikuar nga sulme ajrore, sipërfaqësore dhe nënujore në bashkëpunim midis dy Forcave Detare.

Stërvitje e përbashkët mes Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare spanjolle



Efektivat e Policisë për Kufirin dhe Migracionin do të zhvillojnë një trajnim në Qendrën Stërvitore, Pashaliman

Në Bazën Detare Pashaliman, në funksion me masat e marra për fillimin e sezonit turistik u zhvillua ceremonia e fillimit të programit mësimor praktik - teorik, të kursit funksional "Për mjetet e vogla lundruese, klasi A", për efektivat e Policisë për Kufirin dhe Migracionin, që do të trajnohen në Qendrën e Stërvitjes Bazë në Pashaliman.

Në fazën e parë dyjavore do të trajnohen 27 efektivë dhe në total 105 efektivë të Policisë për Kufirin dhe Migracionin. Kursi do të shërbejë për trajnimin e personelit në përdorimin e mjeteve lundruese të lundrimit detar.

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, pasi falënderoi të pranishmit në ceremoni, u shpreh se bashkëpunimi ndër-institucional do të vazhdojë dhe në fusha të tjera, që t'iu sigurojë qytetarëve dhe turistëve siguri lundrimore dhe zbatim të ligjshëm të detare. Në ceremoni morën pjesë drejtori i Policisë për Kufirin dhe Migracionin Vlorë, kryekomisar Eduard Sulejmani dhe përfaqësues të Repartit Social për Kufirin dhe Migracionin "Delta" Vlorë.





OSFA SHKËLQEN NË PREMIERËN BOTËRORE TË VEPRËS GEA 2552, TË KOMPOZITORIT ALEKSANDËR PEÇI

Në Teatrin e Operas dhe Baletit, krahas pianistit të mirënjohur francez Pascal Gallet, solistes Laura Llozi dhe dirigjentes Elda Laro, në Koncertin nr.5 për Piano dhe Orkestër të kompozitorit Aleksandër Peçi, performuan dhe instrumentistët e OSFA-së (Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura) me dirigjent Harlen Nikolli, të cilët sollën për publikun tinguj të magjishëm. Nën kujdesin e Drejtorit Artistik, z. Arben Skënderi, mbrëmja solli emocione të jashtëzakonshme.



BASHKËPUNIME

Ekspertë nga Brukseli, trajnim për emergjencat në Tiranë

Një grup ekspertësh të DG-Echos nga Brukseli ndodhen në Tiranë, për të marrë pjesë në një workshop dyditor, të organizuar nga AKMC dhe në bashkëpunim me strukturat operacionale, ministritë e linjës, dy prefekturat, Agjencinë Shtetërore të Informacionit dhe Gjeohapësirës, Institutin e Gjeoshkencës, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, si dhe agjenci të tjera, që kanë rolin e tyre në Mbrojtjen Civile. Ky bashkëpunim vjen pak kohë pas anëtarësimit të Shqipërisë në Mekanizmin Evropian të Mbrojtjes Civile.

Në fjalën e tij, në nisje të këtij workshop-i, drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Haki Çako, duke i uruar mirëseardhjen ekspertëve të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile, vuri në dukje faktin se prej tre vitesh punë intensive në gjezë të Sistemit të Mbrojtjes Civile, qeveria shqiptare i është nënshtruar një reforme të thellë në sistemin e menaxhimit të fatkeqësive, duke e zhvendosur vëmendjen nga një menaxhim pasiv i situatave, në një menaxhim proaktiv, të orientuar në parandalim dhe gatishmëri, si dhe qëndrueshmërinë e Sistemit të Mbrojtjes Civile si një mekanizëm gjithëpërfshirës dhe funksional.

Drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së, përmendi hapat kryesorë,



duke filluar nga miratimi i ligjit për Mbrojtjen Civile, krijimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, hartimin e 16 akteve nënligjore në funksion të Ligjit 45, tre dokumentet strategjike si dhe Planin Kombëtar të Emergjencave, që pritet të miratohet brenda këtij viti.

Drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së, përmendi edhe misionin e parë të Shqipërisë nën koordinimin e Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile, në mbështetje të situatës së tmerrshme të krijuar nga tërmeti në Turqi.



AKMC certifikon Skuadrën e Vullnetarëve të Reagimit të Shpejtë

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) certifikoi Skuadrën e Vullnetarëve të Reagimit të Shpejtë, të cilët u trajnuan në teori dhe praktikë për disa muaj me radhë, përmes një donacioni të "LëvizAlbania". Të rinjtë e kësaj skuadre u pajisën me certifikatat përkatëse nga AKMC dhe konsiderohen pjesë e rrjetit të vullnetarëve në rastet e fatkeqësive natyrore.

Në ceremoninë e zhvilluar me rastin e certifikimit të tyre, drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako, e vuri theksin tek kjo iniciativë, duke e cilësuar atë si një vizion dhe vullnet, që i shërben Mbrojtjes Civile, por edhe krijimit të një kulture të përhershme për krijimin, trajnimin dhe ngritjen e rrjeteve të vullnetarëve në Shqipëri. Zoti Çako tha se në principet e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, por edhe një reforme të jashtëzakonshme që është ndërmarrë deri tani, por edhe më shumë në të ardhmen, vullnetarizmi është një pjesë e rëndësishme, ndërsa i cilësoi të rinjtë e Skuadrës së Reagimit të Shpejtë, si partnerë: "Besoj në misionin, besimin dhe përgjegjësitë tuaja. Ju do të



jeni promotorë për të ndryshuar situatat. Keni një mision të rëndësishëm dhe në trajnimin disamujor me ekspertët e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile keni marrë bazat, sepse, për ne fokusi është Mbrojtja Civile", - tha Çako, ndërsa u bëri të ditur të rinjtë të këtij rrjeti vullne-

tarësh, se për herë të parë u miratua nga qeveria shqiptare, Strategjia e Riskut nga Fatkeqësitë Natyrore, një dokument që ka munguar deri më tani.

Duke folur për vullnetarizmin, zoti Çako u ndal tek ky proces, të cilin e quajti një investim të së ardhmes dhe vlerë të



shtuar për Mbrojtjen Civile, referuar praktikave më të mira evropiane.

Shqipëria është anëtarësuar tashmë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile Evropiane dhe po punohet me të gjithë kuadrin ligjor për të qenë dhe vepruar njësoj si agjencitë e tjera të Mbrojtjes

Civile, ku një element mjaft i rëndësishëm është vullnetarizmi. Zoti Çako foli edhe për aspektin ligjor, një nga sfidat e tjera që ka shërbimi vullnetar dhe për të cilin janë duke punuar grupe pune, për të finalizuar deri në detaje këtë strukturë.

SAMITI NORDIK SAMAK, NË HELSINKI

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Koha për të mirëpritur Finlandën dhe Suedinë si anëtarë të NATO-s

Në një fjalim në krah kryeministres Sanna Marin, Stoltenberg përgëzoi mbështetjen e fortë që Finlanda i ka dhënë Ukrainës në këtë moment kritik të luftës së agresionit të Rusisë. “Lufta e Presidentit Putin kundër Ukrainës vazhdon dhe nuk ka shenja se ai po ndryshon planet e tij. Putin dëshiron të kontrollojë Ukrainën dhe nuk po planifikon paqen, por po planifikon më shumë luftë. Prandaj është jashtëzakonisht e rëndësishme që t’i ofrohet mbështetje Ukrainës. Unë përgëzoj mbështetjen e fortë që Finlanda i ka dhënë Ukrainës. Kjo bën një ndryshim në fushën e betejës çdo ditë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, kur vizitoi Helsinkin, më 28 shkurt 2023. Ai ndodhej atje për takime me zyrtarë të lartë dhe për të marrë pjesë në Samitin Nordik SAMAK. Ndërkohë që të gjithë aleatët e NATO-s kanë marrë një vendim historik për të ftuar Finlandën dhe Suedinë për t’u bërë anëtarë të Aleancës, 28 vende nga 30 kanë nënshkruar protokollin e anëtarësimit. “Ne po bëjmë përparim. Para disa javësh u takova me Presidentin Erdogan dhe ramë dakord që javën e ardhshme të kemi një takim me Finlandën, Suedinë dhe Turqinë në Bruksel. Mesazhi im është se Finlanda dhe Suedia kanë përmbushur atë që kanë premtuar në marrëveshjen trepalëshe që bënë me Turqinë qershorin e kaluar në Madrid. Pra, tani është koha për të ratifikuar dhe për të mirëpritur plotësisht Finlandën dhe Suedinë si anëtarë”, - tha Stoltenberg për gazetarët.

Edhe në fjalimin e tij në Samitin Nordik SAMAK, Stoltenberg përgëzoi vendet nordike për mbështetjen e të drejtës së Ukrainës për vetëmbrojtje, duke e quajtur këtë gjë moralisht të drejtë për të bërë, dhe gjithashtu në interesin tonë të sigurisë. “Ne nuk e dimë se kur do të përfundojë kjo luftë, por kur të përfundojë, ne duhet të sigurohemi që historia të mos përsëritet. Presidenti Putin nuk mund të vazhdojë të shkatërronë sigurinë evropiane”, - tha ai. Ai shtoi se: “Ne duhet t’i mundësojmë Ukrainës të pengojë dhe të mbrohet kundër agresionit të ardhshëm. Ne duhet të vendosim marrëveshje afatgjata për sigurinë e Ukrainës, sepse e ardhmja e Ukrainës është në familjen euroatlantike”.

Ai kujtoi Aktin Final të Helsinkit që ndihmoi në uljen e tensioneve të Luftës së Ftohtë, duke nxitur bashkëpunimin dhe duke përfshirë parimet e lirisë dhe të drejtave të njeriut. 35 vende nga Amerika e Veriut dhe Evropa nënshkruan atëherë Aktin Final të Helsinkit, përfshirë edhe Bashkimin Sovjetik dhe u angazhuan për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë paqësore, respektimin e kufijve sovranë dhe përmbajtja nga kërcënimet ose përdorimi i forcës. “Presidenti Putin tani i ka thyer këto parime. Mund të jemi të tronditur nga brutaliteti i luftës në Ukrainë, por nuk duhet të habitemi”, - tha shefi i NATO-s. Kjo është pjesë e një modeli të agresionit rus gjatë shumë viteve, në Grozny, në Gjeorgji, në Aleppo, në Krime dhe Donbas dhe tani, pushtimi i plotë i Ukrainës. Aleatët e NATO-s ndanë inteligjencë të saktë në lidhje me planet e Moskës për pushtimin shumë muj përpara. “Ne bëjmë çdo përpjekje për t’u angazhuar në dialog diplomatik dhe politik me Rusinë për të parandaluar luftën. Por pavarësisht thirrjeve tona,



Presidenti Putin zgjodhi të sulmojë. Një vit më vonë, Putin nuk po përgatitet për paqe. Ai po përgatitet për më shumë luftë. Pra, ndërsa luftimet vazhdojnë, ne tashmë mund të nxjerrim disa mësimet nga lufta”, - tha Stoltenberg.

Lidhur me mësimet e nxjerra nga kjo luftë, Sekretari i Përgjithshëm bëri thirrje për forcimin e vazhdueshëm të parandalimit dhe mbrojtjes. “Në fund të Luftës së Ftohtë, shumë prej nesh në këtë sallë besonin se mund të ndërtonim një marrëdhënie më të mirë me Rusinë, - tha ai, - por Presidenti Putin zgjodhi të largohej nga bashkëpunimi dhe dialogu, ai ka lënë një gjurmë premtimesh të thyera, shkatërroi parimet themelore të sigurisë globale, duke sulmuar vendet fqinje dhe u përpoq të minonte demokracitë tona”. Stoltenberg vuri në dukje se Rusia po pezullon Traktatin e Ri START për kufizimin e armëve bërthamore, si shembulli i fundit i mungesës së respektit të Moskës për normat ndërkombëtare. Ai shtoi se “ne duhet të pranojmë se fundi i kësaj lufte nuk do të jetë një kthim në normalitet në marrëdhëniet tona me Rusinë. Nuk ka kthim prapa. Në një botë më të rrezikshme, ne nuk mund të përballojmë më ta trajtojmë mbrojtjen si opsionale. Është një domosdoshmëri.” Ai tha gjithashtu se është e rëndësishme të shpenzohet më shumë në mbrojtje, “pasi kur shpenzojmë më shumë në mbrojtje, ka më pak para për detyra të tjera të rëndësishme, sepse asgjë nuk është më e rëndësishme se siguria jonë dhe kjo është arsyeja pse duhet të investojmë më shumë në mbrojtje”.

Sekretari i Përgjithshëm theksoi gjithashtu se përfundimi i pranimit të Finlandës dhe Suedisë është një prioritet për NATO-n dhe po bëhet përparim ai shtoi se takimi tjetër i Mekanizmit të Përbashkët të Përhershëm në Selinë e NATO-s, javën e ardhshme bashkë me Turqinë, Finlandën dhe Suedinë, do t’i shërbejë kësaj. Stoltenberg e bëri të qartë gjithashtu se Finlanda dhe Suedia tani janë më të sigurta se përpara se të aplikonin. “Ju jeni ulur në tryezën e NATO-s dhe po integrohni në strukturat tona politike dhe ushtarake. NATO ka rritur praninë e saj në rajon; ne po ushtrohemi më shumë së bashku; dhe

shumë aleatë i kanë dhënë Finlandës dhe Suedisë garanci sigurie, kështu që është e paimagjinueshme që aleatët e NATO-s të mos vepronin nëse siguria ju kërcënohej”. Ndërsa ndodhej në Finlandë, Sekretari i Përgjithshëm u takua edhe me Presidentin Sauli Niinistö dhe ministrin e Jashtëm Pekka Haavisto.

Anëtarësimi i Ukrainës në NATO është një perspektivë afatgjatë

Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg gjatë vizitës së tij në Finlandë tha se Ukraina do të bëhet anëtare e aleancës veri-atlantike në një periudhë afatgjatë, por tha se çështje më me rëndësi tani është që ajo të mbetet shtet i pavarur përballë luftës së Rusisë. “Aleatët e NATO-s janë pajtuar që Ukraina do të jetë anëtare e aleancës sonë, mirëpo ajo është perspektivë afatgjatë”, - iu tha Stoltenberg gazetarëve gjatë vizitës në kryeqytetin finlandez, Helsinki. Stoltenberg shtoi se “çështja kyçe tani është që Ukraina të triumfojë si komb i pavarur sovran, prandaj na duhet ta mbështesim Ukrainën”.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha se ajo që bëjnë aleatët e NATO-s dhe gjithashtu partnerët si Finlanda dhe Suedia, si dhe Bashkimi Evropian dhe shumë të tjerë, është se po ofrohet një nivel i paprecedentë mbështetjeje ushtarake për Ukrainën. “Ne nuk jemi palë në konflikt, por duhet të kujtojmë se çfarë është kjo. Kjo është një luftë agresioni e nisur nga Presidenti Putin kundër Ukrainës. Ata kanë të drejtë të mbrohen. Kjo është e drejtë, e cila është e sanksionuar në Kartën e OKB-së, dhe ne kemi të drejtë të ndihmojmë në mbështetjen e Ukrainës në mbrojtjen e të drejtës së vetëmbrojtjes. Por NATO ka edhe një detyrë tjetër dhe ajo është të parandalojë përshkallëzimin, të parandalojë që kjo të bëhet një luftë e plotë midis Rusisë dhe NATO-s. Prandaj, ne kemi rritur gjithashtu praninë tonë ushtarake në pjesën lindore të Aleancës, gjithashtu në rajonin e Baltikut për të dërguar një mesazh të qartë se një sulm ndaj një aleati të NATO-s do të shkaktojë përgjigjen nga e gjithë Aleanca. Gjëja e rëndësishme tani është të mbështesim Ukrainën. Askush nuk mund

të thotë saktësisht se kur përfundon kjo luftë, por kur të përfundojë, ne duhet të sigurohemi që historia të mos përsëritet që Presidenti Putin të mos vazhdojë të sulmojë fqinjët. Dhe për këtë arsye ne duhet të forcojmë aftësitë ushtarake të Ukrainës, por gjithashtu të kërkojmë korniza që mund të sigurojnë që Presidenti Putin, Rusia të mos pushtojnë Ukrainën edhe një herë tjetër”.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha se “aleatët kanë rënë dakord që Ukraina do të bëhet anëtare e aleancës ushtarake të NATO-s, por në të njëjtën kohë kjo është një perspektivë afatgjatë, çështja tani është të sigurohet që Ukraina të mbizotërojë si një komb sovran dhe i pavarur, dhe për këtë arsye ne duhet të mbështesim Ukrainën”, tha ai.

Anëtarësimi i Finlandës dhe Suedisë në Aleancë, prioritet kryesor

Kërkesat e Finlandës dhe Suedisë për t’u bashkuar me aleancën ushtarake të NATO-s janë një prioritet kryesor, tha Sekretari i Përgjithshëm. “Tani është koha për të ratifikuar dhe për të mirëpritur plotësisht Finlandën dhe Suedinë si anëtarë”, - tha ai në një konferencë shtypi të përbashkët me kryeministren e Finlandës Sanna Marin në Helsinki. “Është e paimagjinueshme që do të kishte ndonjë kërcënim kundër Finlandës apo Suedisë pa reaguuar NATO”, - shtoi ai. Stoltenberg tha më tej se, deri më tani, Finlanda dhe Suedia kanë pasur procesin më të shpejtë të anëtarësimit në historinë moderne të NATO-s. Ai e përsëriti këtë gjithashtu edhe në samitin nordik të Helsinkit.

“Ky është një prioritet kryesor për NATO-n dhe për mua personalisht. Ne po punojmë shumë për këtë dhe duhet të kujtojmë se deri më tani ky është procesi më i shpejtë i anëtarësimit në historinë moderne të NATO-s”, - u shpreh Stoltenberg. Finlanda dhe Suedia aplikuan në maj, në qershor të gjithë aleatët e NATO-s ranë dakord të ftojnë Finlandën dhe Suedinë dhe më pas të 30 aleatët gjithashtu Turqia, ranë dakord për protokollin e anëtarësimit dhe kanë nënshkruar protokollin e anëtarësimit dhe deri më tani 28 nga 30 aleatë që i kanë ratifikuar tashmë në parlamentet kombëtare. Parlamenti hungarez e ka bërë të qartë se do të fillojë diskutimet brenda pak ditësh kështu që shpresoj që ato të ratifikohen së shpejti. Kur bëhet fjalë për Turqinë, ata kanë shprehur disa shqetësime kryesisht për Suedinë. Mesazhi im është se Finlanda dhe Suedia në fakt kanë përmbushur atë që kanë rënë dakord në marrëveshjen trepalëshe. Më lejoni të shtoj edhe një gjë, dhe ajo është se Finlanda dhe Suedia janë në një vend shumë më të mirë tani se sa më parë të aplikonin, sepse si të ftuar, Finlanda dhe Suedia ulen në tryezën e NATO-s, janë integruar në strukturat civile dhe ushtarake të NATO-s. Disa aleatë të NATO-s dhanë gjithashtu garanci dypalëshe sigurie, kështu që është e paimagjinueshme që do të ketë ndonjë kërcënim kundër Finlandës ose Suedisë pa reaguuar NATO-ja, kështu që nuk mund t’ju jap një datë të saktë, por ne po punojmë që kjo të ndodhë

sa më shpejt të jetë e mundur”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. Ai tha se vendimet në NATO merren me konsensus dhe tashmë vendimi është marrë. “Ne i bëjmë ato në qershor, kur të 30 aleatët morën vendimin për të ftuar Turqinë, dhe ftuam Finlandën dhe Suedinë si anëtarë të plotë dhe e morëm vendimin të 30-të, kur ramë dakord për protokollin e anëtarësimit, ajo që mbetet tani janë vendime që merren si aleatë individualë dhe ky është ratifikimi në parlamentet kombëtare”, - dha sqarimin për gazetarët shefi i NATO-s. Pra ky nuk është një vendim që mund ta marrim së bashku, ai është një vendim që duhet të merret nga çdo shtet dhe deri më tani vendimin e kanë ratifikuar 28 vende. Për 2 vendet e mbetura pa ratifikuar vendimi mund të mos jetë prioritet, por për është për Aleancën në tërësi është prioritet për mua dhe ne po punojmë shumë dhe po përdorim argumentin se sigurisht do të jetë mirë për Finlandën dhe Suedinë, por do të jetë mirë edhe për NATO-n për të gjithë prej nesh të kemi Finlandën dhe Suedinë si anëtarë sa më shpejt të jetë e mundur”, - tha Stoltenberg. Ai ritheksoi gjithashtu se kohët e fundit ka pasur diskutime të mira me Presidentin Erdogan në Ankara dhe po bëhet përparim. “E kam bërë të qartë se Finlanda dhe Suedia kanë përmbushur angazhimet e tyre në Memorandumin Trepalësh të rënë dakord me Turqinë në Samitin e NATO-s. Dhe se ka ardhur koha për të finalizuar procesin e ratifikimit. Më vjen mirë që presidenti Erdogan pranoi të rifillojë diskutimet. Dhe javën e ardhshme do të thërras një takim tjetër të Mekanizmit të Përbashkët të Përhershëm në Selinë e NATO-s. Nga ana tjetër ministri i Jashtëm turk Mevlut Cavusoglu tha, më 27 shkurt, se bisedimet e vendit të tij me Suedinë dhe Finlandën mbi ofertën e anëtarësimit të vendeve nordike në NATO do të rifillojnë më 9 mars. Gjithashtu edhe parlamenti hungarez pritet të përfundojë së shpejti ratifikimin tha Stoltenberg. “Aplikimet e Finlandës dhe Suedisë në NATO tashmë e kanë forcur sigurinë tuaj”, - iu tha pjesëmarrësve në samit ai. “Ju jeni ulur në tryezën e NATO-s dhe duke u integruar në strukturat tona politike dhe ushtarake, NATO ka rritur praninë e saj në rajon. Ne po stërvitemi më shumë së bashku dhe shumë aleatë i kanë dhënë Finlandës dhe Suedisë garanci sigurie”, - tha ai. Pra, është e paimagjinueshme që aleatët e NATO-s të mos vepronin nëse siguria juaj kërcënohej.

NATO është një familje e madhe prej 30 kombesh të lira në të gjithë Evropën dhe Amerikën e Veriut dhe së shpejti bëhet 32. “Ne përfaqësojmë gjysmën e fuqisë ushtarake të botës dhe gjysmën e fuqisë ekonomike të saj. Ne ofrojmë garanci sigurie si askush tjetër. Një për të gjithë, dhe të gjithë për një. Bashkimi i familjes nordike rreth tryezës së NATO-s do ta bëjë Finlandën dhe Suedinë më të sigurta, Aleancën e NATO-s më të fortë dhe e gjithë zona euroatlantike më e sigurt. Është koha për të finalizuar procesin dhe për të pasur Finlandën dhe Suedinë si anëtarë të plotë të Aleancës sonë”.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Adoleshenca: "Mos më jepni këshilla! Di të gaboj vetë"

Një video e një shërri banal u shpërnda gjerësisht në mediat dhe portalet shqiptare: "Vajza të mitura, sherr me njëra-tjetrën".

Kjo ngjarje ka ndodhur në Tiranë, ku disa nxënëse të shkollës 9-vjeçare janë rrahur me njëra-tjetrën. Njëra nga vajzat është tërhequr zvarrë dhe e kanë goditur, ndërkohë që nuk kanë munguar as fjalët banale.

Videoja e shpërndarë nuk ishte thjesht një xhirim adoleshentësh me fjalor degjenerues, por fakti që po rrisim fëmijë që në rrugëtimin e tyre jetësor nuk po mësojnë të njohin rregulla dhe kufi.

Gjyshërit tanë të mençur thoshin: "ç'të mbjellësh, do korrësh", dhe për këtë jemi koshient, se këta fëmijë edukatën bazë e marrin në familje, e cila mesa duket ka probleme të mëdha, dhe kjo nuk do shumë studime për të kuptuar sjelljen e adoleshentëve sot.

Në video shikohet se si një grup vajzash, jo më shumë se 14-15 vjeç zihen, rrihen dhe përdorin një fjalor banal, të pahijshëm për askënd.

Pikërisht këtu duhet të ndalemi. Përse për këto vajza, kjo sjellje dukej sikur të ishte diçka normale?

Sepse mjedisi rrethues është i tillë. Shoqëria shqiptare gjendet tashmë e përthithur brenda një sistemi dhune dhe agresiviteti të rëndë.

Dhunën e hasim kudo në jetën e përditshme. Shqiptarët për habi janë agresivë ndaj njëri-tjetrit për gjërat më banale.

Agresivitetet ka kudo, në lagje, në punë, në lokal, në restaurant, në palestër, në autobus.

Në edukimin e adoleshentëve, pa mohuar rolin e shoqërisë, shkollës, medias dhe mjedisit, një nga metodat më të efektshme për parandalimin e veprimeve antisociale të adoleshentëve është kujdesi i familjes, përkatësisht prindërve apo kujdestarët të tyre, duke krijuar "ura" të komunikimit të mirëfilltë me adoleshentin. Mos kujdesi dhe mos qasja e duhur e prindërve apo indiferenca në ndërtimin e marrëdhënieve me adoleshentët, mund t'u kushtojë shtrenjtë, jo vetëm për prindërit e tyre, por edhe shkollën dhe rrethin shoqëror dhe shoqërinë në tërësi. Statistikat tregojnë se, si rrjedhojë e fakteve të mësipërme, te adoleshentët vihen re probleme të ndryshme si: përdorimi i alkoolit, drogës, duhanit, probleme dhe konflikte në familje, shoqëri dhe në shkollë, përfshirja në mjedise negative ose keqbërësish të moshave më të



rritura, përplasje me ligjin, probleme shëndetësore, ulje e nivelit të notave, braktisje shkolle, ndryshim tërësor i shoqërisë, humbje apo divorc të prindërve, stres, depresion, rrethana këto që ndikojnë në lindjen e sjelljeve antisociale. Këto dukuri si dhe kriza e adoleshencës, kur nuk kapërcehen, prodhojnë stres, mos parandalimi i të cilit sjell pasoja negative, që i tejkalon sjelljet antisociale, duke shkuar deri tek veprimtaria kriminale apo edhe vetëvrasja, në thelb të së cilës qëndron ndjenja e dëshpërimit, mos vlerësimit dhe mungesa e shpresës.

Nëse ata marrin një edukatë të gabuar, atëherë do të vijë deri të edukata përmirësuese apo riedukuese, që është punë e mundimshme, dhe merr kohë shumë të gjatë, kur dihet nga praktika se, më lehtë është të parandalosh, se sa të shërosh.

Adoleshenti, në përgjithësi nuk përdor asnjëherë fjalorin që përdor jashtë

Në ambientet shoqërore ai duket se është i detyruar të përdorë fyerjet e imponuara nga mjedisi. "Shokët do të tallen me mua, nëse unë nuk shaj si ata, ose ata do të më quajnë fëmijë mamaje, etj...", mendon një fëmijë i kësaj moshe. Pikërisht në këtë moment ndihet edhe ndërhyrja e prindërve. Për ta bërë të kuptojë se nuk të bën të rritur një fjalor i tillë, por sjelljet elegante dhe të kulturuar.

Një problem shumë i rëndësishëm sot për mbarë brezin e ri është pavarësia e tepërt që ata gjejnë si në familje ashtu edhe në ambientet shkollore.

Në të shumtën e rasteve prindi harron detyrën që ka dhe mësuesi neglizhon punën e tij. Shpeshherë prindi i lejon pavarësi të plotë fëmijës së tij dhe në të shumtën e rasteve kërkon që të vendosë marrëdhënie shoqërore me të. "Duke e trajtuar atë si shok, prindi harron shenjtërinë e të qenit "nënë" ose "baba". Prindi duhet t'i shpjegojë me mënyrat më të duhura se marrëdhënia prind-fëmijë qëndron shumë më lart se ajo e një shoku me një shok. Marrëdhënia "prind-fëmijë" është e barabartë me "shok-shok + shenjtërinë e të qenit nënë ose baba". Në këtë mënyrë prindi e bind fëmijën e tij që të mos pranojë edhe pavarësinë e plotë që ai mund të kërkojë. Adoleshenti, duke qenë autonom në këtë marrëdhënie, ndien edhe përgjegjësinë që ka ndaj prindit dhe familjes në çdo hap që hedh. Në marrëdhëniet që prindit i duhet të ketë me fëmijën e kësaj moshe, i duhet që të mos kërkojë gjithmonë arsye në veprimet e tij, pasi kjo mund ta zhgënjë në çdo çast. Prindi mund të sillt rreptë vetëm aty ku e shikon të arsyeshme se nuk ka rrugë tjetër. Shkolla e parë e fëmijëve që e kanë shpirtin të shkëlqyer si pasqyrë e që regjistron shpejt si aparatet fotografike janë shtëpitë e veta, kurse edukatorët e parë janë nënat. Përgatitja e nënave si edukatore dhe jo konsumimi i tyre majtas-djathtas, është baza më e rëndësishme për ekzistencën dhe vazhdimësinë e një kombi.

Plotësimi i të gjitha dëshirave të fëmijëve, aq sa fëmija sot është bërë pothuaj "diktator" për familje, kërkon

dhe kushtëzon çdo gjë dhe menjëherë, dhe prindërit duken të paafte, disi lëshojnë pe, dorëzohen para këtyre kërkesave, gabojnë rëndë duke menduar dhe thënë: s'dua që fëmija im të vuajë si unë.

Mungesa e vlerave dhe virtyteve personale, familjare dhe shoqërore, si dhe mungesa e modeleve kulturore dhe shpirtërore. Adoleshentët s'duan dhe s'mund të jenë më si prindërit e tyre, sidomos për familje në rrethe të huaja, në diasporë, si dhe për prindër të varfër dhe të pashkolluar, të trajtuar si "primitivë" dhe të prapambetur. Prindërit s'janë gati aspak të përgatitur për rrethe të reja, për edukim të ri, të hapur, ku kërkohet e mira e përbashkët nëpërmjet bisedimeve, dialogut dhe komunikimit, por më tepër insistojnë në rregullore, në disiplinë, në autoritet edhe të "grushtit" të fortë.

Fëmijët nuk janë për prindër, por prindërit për fëmijë! Kjo vlen në veçanti për botën femërore shqiptare, sepse femrat tona mundohen që zbrazëtitë e tyre afektive dhe emotive jetësore t'i mbulojnë dhe projektojnë në fëmijët e tyre me motivime si, së paku jam nënë, kam fëmijë, ata le të jenë të lumtur, duke harruar detyrën si prind për drejtimin e rrugës se këtij fëmijë.

A dimë të prindërojmë?

Edukatoret e parë të fëmijëve janë prindërit, detyrë e vështirë, shpesh mision i pamundur për t'u realizuar i vlerë.

Prindërit që s'janë të bashkuar dhe koherentë, u japin fëmijëve porosi të gabuara, sepse njëri thotë po, tjetri thotë

jo, duke shkaktuar kështu pasiguri, nervozitet, frikë, shqetësim, dyshim dhe thyerje psikike.

Pjekuria personale dhe martesore, familjare është parakusht për edukimin e fëmijëve, sepse nuk edukojmë me fjalë, me porosi, por më tepër me shembull dhe me jetë. Në familje të papjekur apo në konflikt, fëmijët shpesh shndërrohen në "objekt", lodër apo vegël për ta luftuar çiftin martesor, duke rrënuar kështu veten, por edhe fëmijën dhe fëmijërinë e tyre.

Familja, edhe pse ka pësuar ndryshime të mëdha dhe rrënjësore, prapë mbetet rrethi i parë natyror i çdo edukimi, përgjegjësie për fëmijët.

Familja s'mund të jetë indiferente, neutrale, t'i edukojë fëmijët vetëm për përshtatje ndaj jetës dhe punës, por duhet t'u japë përvojë kujdesi, mirësie, butësie dhe dashurie, sepse është bartëse dhe edukuese për jetën dhe për vlerat.

Edukimi është kryesisht aftësimi i fëmijës për zgjedhjen e vlerave dhe të virtyteve, si ndërmjetësim mes familjes, shkollës, shoqërisë.

Sa ja kemi dalë?!

'Adoleshenca nuk është sëmundje, por një fazë ekzistence me karakteristikat e veta. Ashtu si pleqëria, që është një fazë e jashtëzakonshme ekzistence, nga e cila njeriu nuk duhet të shpëtojë, por duhet ta jetojë, sepse ka vlerë të madhe për botën shoqërore'. Rrugëtimin i gjatë dhe i vështirë, por duke bashkëpunuar të gjitha institucionet së bashku, familja, shkolla, shoqëria, mund të arrijmë të edukojmë breza, të cilët e nesërmja e panjohur i pret 'krahë hapur'.

Monedha shqiptare dhe autenticiteti i saj në rrjedhën e historisë

Monedha shqiptare, Lek, doli në qarkullim për herë të parë në shkurt të 1926. Ajo e mori emrin nga Aleksandri i Madh, emri i të cilit shpesh shkurtohet në "Leka" në gjuhën shqipe.

Portreti i Aleksandrit shfaqet në pjesën e përparme të monedhës 1 lek ndërsa pjesa e prapme e tij e tregon atë mbi kalë.

Emri "qindarkë" rrjedh nga fjala shqipe "qind" që do të thotë një qind.



FRANGA

Midis viteve 1926 dhe 1939, emri u përdor për monedhën shqiptare të arit me vlerë 5 lekë Shqiptare, e përdorshme në transaksionet ndërkombëtare.



MONEDHAT

Leku i parë

Në vitin 1926, monedhat e bronzit u paraqitën në vlerat e 5 dhe 10 qindarka leku, së bashku me nikelin 1/4 (5 centë), 1/2 dhe 1 lek si dhe monedhën e argjendtë 1, 2 dhe 5 franga ari. Pjesa e përparme e frangave (monedhe) përshkruan Mbretin Ahmet Zogu. Në vitin 1935, qindarkat 1 dhe 2 prej ari dolën në qarkullim të barasvlershme me 5 dhe 10 qindarka leku. Ky serial monedhash përshkruante motivet e veçanta neoklasike të cilat thuhet se janë ndikuar nga mbreti italian, Victor Emmanuel III, i cili përflitet se ka qenë një koleksionues monedhash. Këto monedha përmbajnë germën "R" dhe "V" të cilat përfaqësojnë Romën dhe Venecian.

Nën drejtimin e Benito Musolinit, Italia pushtoi Shqipërinë dhe emetoi një seri të re monedhash në vitin 1939 në vlerat 0.20, 0.50 dhe 1 lek prej materiali të çelikut të pandryshkur. Si dhe monedha argjendi 2, 5 dhe 10 lek. Monedhat dolën në qarkullim deri në 1941 dhe kanë portretin e Mbretit Italian, Victor Emmanuel III në pamjen e përparme si dhe shqiponjën italiane dhe sqeparin në pjesën e prapme.

Në 1947, pak pasi partia komuniste erdhi në fuqi, monedhat më të vjetra u tërhoqën nga qarkullimi dhe u paraqitën zinku 1/2, 1, 2 dhe 5 lekë.

Të gjitha këto përshkruanin simbolin kombëtar socialist. Kjo seri u prodhuan përsëri në 1957 dhe u përdor deri në vitin 1965, kur ndodhi edhe reforma e monedhës.

Leku i dytë

Në 1965, monedhat prej alumini (të vitit 1964) u prezantuan në vlerat 5, 10, 20 dhe 50 qindarka dhe 1 lek. Të gjitha monedhat përshkruanin



emblemën shtetërore të Socializmit. Në 1969, një seri e dytë e monedhave prej alumini, me vlerë 5, 10, 20, 50 qindarka dhe 1 lek u lëshuan në kuadrin e festimeve të çlirimit nga fashizmi në 1944. Në 1988, ndodh një ridizenjim i tretë i monedhave prej alumini 5, 10, 20, 50 qindarka dhe 1 lek. Monedha 50 qindarka dhe 1 lek kishin të njëjtën madhësi, peshë dhe paraqitje. Monedha 1 lek kishte si mbishkrim "Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë".

Leku i tretë



Në vitet 1995 dhe 1996, monedha të reja dolën në qarkullim në vlerat 1, 5, 10, 20 dhe 50 lekë për të vazhduar me 100 lekë në vitin 2000.

Monedhat përkujtimore

Në vitin 2001, 100 dhe 200 lekë dolën në qarkullim nën temën integrimi i Shqipërisë në BE dhe 50, 100, dhe 200 lekë në kujtim të 500-vjetorit të Statujës së Davidit. Në vitin 2002, 50 lekë dhe 100 lekë dolën në qarkullim në

qarkullim 50 lekëshi, në kujtim të 100-vjetorit të vdekjes së Jeronin De Radës. Në 2004, e njëjta monedhë doli në qarkullim e frymëzuar nga antikiteti shqiptar. Ato përshkruanin kostumet tradicionale të Shqipërisë dhe Dean e lashtë. Në vitin 2005, 50 lekë u lëshua në 85-vjetorin e shpalljes së Tiranës si kryeqytet.

Kartëmonedhat

Në vitin 1926, Banka Kombëtare e Shqipërisë prezantoi kartëmonedhat në vlerat 1, 5, 20 dhe 100 franga ari. Në vitin 1939, kartëmonedhat u emetuan në vlerat 5 dhe 20 franga. Ato u

ndoqën në vitin 1944 nga kartëmonedhat 2, 5, 10 lek dhe 100 franga. Në 1945, Banka e Shqipërisë emetoi më shumë kartëmonedha të Bankës në vlerat 10 lekë, 20 dhe 100 franga. Kartëmonedha të rregullta u emetuan edhe gjatë vitit 1945 në vlerat 1, 5, 20, 100 dhe 500 franga. Në vitin 1947, doli Dekretligji nr. 445, datë 07.07.1947 "Mbi heqjen nga qarkullimi të bankënotave të quajtura franga dhe emetimin e një emisioni të ri", si njësi bazë e monedhës në vend të Frangut u caktua Leku. Në vitin 1947, leku u adoptua si vlera kryesore me kartëmonedhat 10, 50, 100, 500 dhe 1000 lekë.



90-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Në 2003, doli në

Muaji i Historisë së Grave 2023: Festimi i Grave Astronaute

“Një zog nuk mund të fluturojë vetëm me një krah. Fluturimi njerëzor në hapësirë nuk mund të zhvillohet më tej pa pjesëmarrjen aktive të grave”, – Valentina Tereshkova

“Nëse duam shkencëtarë dhe inxhinierë në të ardhmen, ne duhet të kultivojmë vajzat po aq sa djemtë”, – Sally Ride

“Bashkëpunimi ndërkombëtar është shumë i nevojshëm. Kinezët kanë një thënie: “Kur të gjithë njerëzit të mbledhin drutë, ju do të bëni një zjarr të madh”, – Liu Yang

Që nga marsi 2023, 72 gra kanë fluturuar në hapësirë. Prej tyre, 44 kanë punuar në Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës si anëtarë të ekipazhit të ekspeditës me kohëzgjatje të gjatë, si vizitore në fluturimet e montimit të anijeve kozmike ose si pjesëmarrëse të fluturimeve hapësinore në misione me kohëzgjatje të shkurtër. Ky artikull njihet dhe rëndësishme të këtyre grave nga shumë kombe, si dhe grave pioniere që i paraprinë në hapësirë. Shumë gra të tjera kontribuuan në montimin e stacionit dhe kërkimin e kryer në bord çdo ditë, duke përfshirë ato në terren që shërbyen si drejtore qendrash, menaxhere, drejtore fluturimi dhe në shumë role të tjera për të ndjekur eksplorimin e hapësirës. Arritjet e tyre do të kontribuojnë në përpjekjet e NASA-s për të zbuluar gruan e parë dhe personin e parë me ngjyrë në Hënë dhe ndoshta dërgimin e ekipazheve të para në Mars në dekadat e ardhshme.

Epoka e grave në hapësirë filloi më 16 qershor 1963, kur kozmonautja sovjetike Valentina V. Tereshkova u nis në bordin e anijes kozmike “Vostok 6”. E zgjedhur nga një grup prej pesë femrash të përzgjedhura për trajnim, Tereshkova përfundoi një mision tre-ditor dhe hyri në librat e historisë si gruaja e parë që u rrotullua rreth Tokës. Kaluan gati 20 vjet përpara se një grua tjetër të fluturonte në hapësirë. Në janar 1978, Bashkimi Sovjetik zgjodhi fshehurazi një grup prej nëntë grash kozmonaute në vitin 1980. Më 19 gusht 1982, një nga këto gra, Svetlana Y. Savitskaya, u nis me dy shokët e saj të ekipazhit në bordin e “Soyuz T-7” për një mision njëjavor. Të nesërmen, ata u bashkuan me dy anëtarët e ekipazhit rezidentë me kohëzgjatje të gjatë në bordin e “Salyut 7”, duke shënuar herën e parë që një stacion hapësinor priti një ekipazh me gjini të përzier. Dhjetë muaj më vonë, më 18 qershor 1983, astronautja Sally K. Ride bëri histori si gruaja e parë amerikane në hapësirë, duke kaluar shtatë ditë në anijen hapësinore “Challenger” gjatë misionit STS-7.

Savitskaya bëri histori përsëri më 25 korrik 1984, si gruaja e parë që mori pjesë në një shëtitje në hapësirë gjatë fluturimit të saj të dytë për në “Salyut 7”. Më pak se tre muaj më vonë, më 11 tetor, Kathryn D. Sullivan përfundoi ecjen e parë në hapësirë nga një grua amerikane nga anija kozmike “Challenger” gjatë misionit STS-41G. Me Ride si një nga shokët e ekipazhit të Sullivan, fluturimi shënoi herën e parë që një ekipazh hapësinor përfshinte dy gra. Helen P. Sharman është gruaja e parë që vizitoi stacionin hapësinor rus “Mir”. E zgjedhur në vitin 1983, Dr. Roberta L. Bondar u nis me grua e parë kanadeze në hapësirë gjatë fluturimit STS-42 “Discovery” në janar 1992, si specialiste e ngarkesës dhe neurologja e parë në hapësirë.

E zgjedhur në klasën e astronautëve të NASA-s në vitin 1990, Ellen Ochoa u nis me grua e parë hispanike në hapësirë në prill 1993 si specialiste e misionit në fluturimin STS-56 të “Discovery”, misioni i dytë i Laboratorit Atmosferik



Tereshkova pak para se të hipte në kapsulën e saj Vostok 6 për fluturimin e saj historik në hapësirë.

për Aplikime dhe Shkencë. Një flautiste e arritur, ajo i binte flautit gjatë kohës së lirë gjatë misionit. E zgjedhur në 1985 si astronaute nga Agjencia Kombëtare e Zhvillimit të Hapësirës në Japoni, tani Agjencia Japoneze e Kërkimit të Hapësirës Ajrore (JAXA), Dr. Chiaki Mukai u nis me grua e parë japoneze në hapësirë në korrik 1994, kur ajo kaloi 15 ditë si specialiste e ngarkesës në misionin STS-65 IML-2 në bordin e “Columbia-s”.

Ndëri i gruas së parë që përfundoi një mision afatgjatë i takon kozmonautes ruse Elena V. Kondakova. Ajo u nis në bordin e “Soyuz TM20”, më 3 tetor 1994, dhe kaloi 169 ditë në stacionin hapësinor “Mir” si anëtare e Ekspeditës 17, duke u kthyer në Tokë më 22 mars 1995. Gruaja e parë amerikane që përfundoi një mision afatgjatë, NASA Astronautja Shannon W. Lucid, u nis në bordin e anijes kozmike Atlantis, më 22 mars 1996, si pjesë e ekipazhit STS-76. Astronauti i dytë i NASA-s që fluturoi si pjesë e Programi “Shuttle-Mir”, Lucid kaloi 188 ditë në bordin e “Mir”, duke vendosur një rekord të ri për fluturimin më të gjatë të vetëm nga një grua, si anëtare e Ekspeditave 21 dhe 22, duke u kthyer në Tokë me STS-79, më 26 shtator. Me Lucid ende në bordin e “Mir”, fluturimi i gushtit 1996 i Claudie André-Deshays, gruaja e parë astronaute franceze që vizitoi stacionin gjatë misionit të saj kërkimor “Cassiopee”, shënoi herën e parë që dy gra jetonin në ndonjë stacion hapësinor. Kur Asambleja e Stacionit Ndërkombëtar të Hapësirës në orbitë, filloi në 1998, astronautet femra morën pjesë që në fillim. Si gruaja e parë që arriti në objektin e ri, astronautja e NASA-s Nancy J. Currie mori pjesë në misionin e parë të asamblesë, STS-88 në dhjetor 1998. Misioni i dytë i montimit të stacionit hapësinor, STS-96 në maj 1999, përfshiu tre gra në ekipazh - astronautët e NASA-s Jernigan dhe Ellen Ochoa, dhe Julie Payette të CSA. Jernigan u nis me grua e parë që mori pjesë në një shëtitje hapësinore në stacionin hapësinor për të instaluar pajisje vinç për detyrat e ardhshme të montimit, me Ochoa si operatorin e krahut robotik. Payette u nis me grua e parë që vizitoi stacionin hapësinor dhe u nis me grua e parë që u kthye në stacionin hapësinor gjatë STS-127 në 2009.

Astronautja e NASA-s Pamela A. Melroy shërbeu si pilote e parë femër në një fluturim anijesh në stacionin hapësinor, në misionin STS-92. Astronautja e NASA-s Susan J. Helms, si anëtare e “Expedition 2”, u nis me grua e parë që përfundoi një mision afatgjatë në stacionin hapësinor, një fluturim 167-ditor midis marsit dhe gushtit 2001.

Një e diplomuar në klasën e parë të Akademisë së Forcave Ajrore të SHBA-së për gratë në vitin 1980, Helms ishte gruaja e parë me përvojë ushtarake që vizitoi stacionin. Ajo mban rekord për ecjen më të gjatë në hapësirë deri më sot, 8 orë 56 minuta.

Astronautja e NASA-s, Eileen M. Collins, kishte bërë histori tre herë më

stacionit hapësinor gjatë “Expedition 16” në 2007. Në vitin 2017, gjatë “Expedition 51”, Whitson u nis me grua e parë që komandonte stacionin për herë të dytë. Gjatë këtij fluturimi të tretë, ajo kaloi 289 ditë në hapësirë, në atë kohë fluturimi më i gjatë i vetëm nga një grua. Që nga marsi i vitit 2023, Whitson mban rekord për kohën më të grumbulluar të fluturimit në hapësirë për një grua si dhe për çdo astronaut amerikan, gjatë tre misioneve afatgjata në bordin e stacionit hapësinor, ajo kaloi gjithsej 665 ditë ose rreth 1.8 vite në hapësirë. Ajo mban gjithashtu rekordin për kohën më të madhe të ecjes në hapësirë për një, me 60 orë e 21 minuta jashtë stacionit gjatë 10 shëtitjeve në hapësirë.

Hera e parë që katër gra fluturuan në bordin e stacionit hapësinor në të njëjtën kohë ndodhi midis 16 dhe 23 maj 2010.

Yamazaki u nis me grua e parë japoneze që vizitoi stacionin hapësinor. Misioni solli katër objekte të reja kërkimore në stacion. Tre javë pas nisjes së anijes, Caldwell Dyson dhe shokët e saj të ekipazhit mirëpritën një treshe të re anëtarësh të ekipazhit afatgjatë, përfshirë astronautin e NASA-s Shannon Walker, duke e bërë “Expedition 24” të parën që përfshin dy gra. Ekspedita tjetër me dy gra u zhvillua midis nëntorit 2014 dhe marsit 2015 - Ekspedita 42 përfshinte kozmonauten e Roscosmos Elena O. Serova, gruaja e parë ruse që bëri një fluturim afatgjatë në stacionin hapësinor, dhe Samantha Cristoforetti, femra e parë nga Italia.

Midis marsit dhe qershorit 2019, McClain dhe astronautja e NASA-s Christina H. Koch ishin në bord si pjesë e “Expedition 59” dhe NASA Astro-

Megan McArthur, gruaja e parë që pilotoi një automjet komercial të ekipazhit, mbërriti në prill 2021 si anëtare e misionit të NASA-s “Crew-2”.

Në prill 2022, kur “Crew Dragon Freedom” u ngrit, “Crew-4” përfshiu astronautin e NASA-s Jessica Watkins, e cila u nis me grua e parë e zezë amerikane që u bashkua një ekipi afatgjatë.

Në tetor 2022, astronautja e NASA-s Nicole A. Mann u nis me grua e parë vendase amerikane në hapësirë dhe gruaja e parë që komandonte një mision “Crew Dragon”, dhe Anna Y. Kikina e Roscosmos u nis me grua e parë ruse që kishte fluturuar në një automjet komercial amerikan. Nisja e Crew-6 në mars 2023 shënoi ekipazhin e parë me kohëzgjatje të gjatë, të gjithë meshkuj, në një automjet komercial të ekipazhit. Rikthimi i planetifikuar i Mann dhe Kikina do të shënojë fundin e periudhës më të gjatë kohore me të paktën një grua që jeton dhe punon në hapësirë, rreth 2 vjet e 5 muaj.

Historia e grave në hapësirë nuk do të ishte e plotë pa përmendur dy gratë nga Republika Popullore e Kinës që kanë fluturuar në hapësirë. Astronautja e parë femër e Kinës, Liu Yang, u nis më 16 qershor 2012, në bordin e anijes kozmike Shenzhou-9 me dy shokët e saj të ekipazhit, duke u ankoruar me stacionin hapësinor eksperimental “Tiangong-1” dy ditë më vonë.

Gratë kanë qenë në ballë të fluturimeve komerciale në hapësirë. Në shtator 2021, dy nga katër anëtarët e ekipazhit të misionit hapësinor privat “Inspiration4” ishin gra: Sian H. Proctor, gruaja e parë afrikano-amerikane që pilotoi një anije kozmike dhe Hayley Arceneaux. Muajin tjetër, aktorja ruse Yulia S. Peresild dhe



Majtas: Në 1999, ekipazhi STS-96 në modulën “Unity Node 1”, me astronauten e NASA-s Tamara E. Jernigan dhe Julie Payette të Agjencisë Kanadeze të Hapësirës në rreshtin e sipërm dhe astronauten e NASA-s Ellen Ochoa në fund djathtas. Mes: Jernigan gjatë ecjes hapësinore STS-96. Djathtas: Payette në modulën Unity Node 1.

parë, së pari në vitin 1995 si pilote e parë femër e një misioni të anijes kozmike (STS-63), herën e dytë në vitin 1997, kur ajo shërbeu si pilote e parë femër e anijes që u ankorua me një stacion hapësinor (STS-84 dhe “Mir”), dhe përsëri në 1999 si komandantja e parë grua e anijes (STS-93).

Më 18 shtator 2006, Anousheh Ansari u nis me grua e parë iraniane në hapësirë, kur u nis me shokët e saj të ekipazhit të “Expedition 14” në bordin e “Soyuz TMA9”. Duke fluturuar si pjesëmarrëse në fluturimet hapësinore përmes një marrëveshjeje tregtare me qeverinë ruse, Ansari kreu katër eksperimente në emër të Agjencisë Evropiane të Hapësirës (ESA) gjatë misionit të saj nëntë-ditor. Përmes një marrëveshjeje të përbashkët midis qeverive të Rusisë dhe Republikës së Koresë, Yi So-yeon, një studiuese në Institutin Korean të Kërkimeve Hapësinore Ajrore (KARI), u nis me grua e parë në hapësirë, kur u nis në bordin e “Soyuz TMA12” me të. Astronautja e NASA-s Peggy A. Whitson bën dallimin si komandantja e parë femër

nautja Jessica U. Meir u bashkua Koch në shtator të atij viti gjatë ekspeditës 61. Koch u kthye në Tokë në shkurt 2020, duke përfunduar një fluturim prej 329 ditësh, misioni më i gjatë i vetëm deri më sot nga një grua.

Ekipazhi i “Expedition 61” kreu një rekord nëntë shëtitje hapësinore midis tetorit 2019 dhe janarit 2020. Koch dhe Meir bënë histori më 18 tetor kur notuan jashtë stacionit hapësinor për të kryer shëtitjen e parë kozmike vetëm për femra, një nga disa që zëvendësuan bateritë e stacionit. Kthimi i Meir në Tokë shënoi fundin e periudhës më të gjatë deri në atë kohë të një pranë të vazhdueshme femërore në stacionin hapësinor – 682 ditë (një vit dhe 10 muaj) nga 8 qershor 2018 deri më 17 prill 2020.

Më 16 nëntor, si anëtare e misionit “Crew-1” të NASA-s në bordin e anijes kozmike të “SpaceX’s Crew Dragon Resilience”, astronautja e NASA-s Shannon Walker u nis me grua e parë që udhëtoi me një automjet komercial të ekipazhit. Astronautja e NASA-s K.

regjisorja e saj kaluan 11 ditë në bordin e stacionit hapësinor, duke filmuar skenat e një filmi të titulluar “The Challenge”, me datën e parashikuar të publikimit më 12 prill 2023. Misioni i dytë Privat i Astronautëve në Hapësirën Ndërkombëtare Stacioni, i planifikuar aktualisht për nisjen në maj 2023, Ax-2 do të përfshijë një ekipazh prej katër vetash që do të kalojnë 10 ditë në bordin e laboratorit orbital, duke kryer eksperimente. Ish-astronautja e NASA-s Whitson dhe drejtoresha e fluturimeve hapësinore njerëzore në Axiom Space, do të jetë komandantja e parë grua e një misioni hapësinor privat. Dy specialistë të misionit nga programi inaugurues i astronautëve të Mbretërisë së Arabisë Saudite, duke përfshirë Rayyanah Barnawi, e cila do të jetë gruaja e parë saudite në hapësirë, do të shërbejnë gjithashtu në ekipazh. Misionet private të astronautëve në stacionin hapësinor janë një pararendës i stacioneve hapësinore komerciale të financuara privatisht si pjesë e përpjekjeve të NASA-s për të zhvilluar një ekosistem dhe treg të lulëzuar në orbitën e Tokës.



Trajtimi i ndotjes dhe krizës energjetike mes liderëve lokalë të BE-së 2023, prioritetet kryesore

Reduktimi i ndotjes së dëmshme në ujërat urbane, mbrojtja e qytetarëve nga azbesti dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit ishin tre nga temat kryesore të diskutuara në takimin e Komisionit ENVE të Komitetit Evropian të Rajoneve (CoR). Prioritetet e Presidencës suedeze të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe rezultatet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për biodiversitetin – COP15 – ishin gjithashtu në tryezën e diskutimit, së bashku me prioritetet e komisionit ENVE për vitin 2023.

Duke hapur takimin, Rafał Trzaskowski (PL/EPP), Kryetar i Bashkisë së Varshavës dhe kryetar i komisionit ENVE dhe i grupit të punës lokale të Green Deal Going, tha: “2022 ishte një vit i vështirë për të gjithë evropianët. Ne u përballëm me çmimet në rritje të energjisë. Na u desh të mbronim shumë qytetarë dhe biznese të BE-së që nuk mund të përballonin faturat e energjisë. Ne ofruam mbështetje humanitare për ukrainasit që kërkonin strehim nga lufta. Dhe ne vazhduam të vuanim nga ndryshimet klimatike ndërsa përjetuam verën më të nxehtë të regjistruar ndonjëherë në Evropë. Pavarësisht kësaj, autoritetet lokale dhe rajonale të BE-së kanë vendosur masa urgjente për të reduktuar konsumin e energjisë, për të rritur efikasitetin e energjisë në ndërtesa



dhe transportin publik dhe për të investuar në burimet e rinovueshme. Ne kemi punuar gjithashtu në gjelbërimin urban dhe në përmirësimin e biodiversitetit dhe cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës. Dhe këtë e kemi arritur edhe në mungesë të mbështetjes adekuate financiare dhe teknike. Kjo tregon ambicien dhe vullnetin tonë kolektiv për të ndërmarrë veprime edhe për vitin e ardhshëm.” Kryebashkiaku Trzaskowski i bëri thirrje gjithashtu Komisionit Evropian që të sigurojë fonde të drejtpërdrejta për autoritetet lokale dhe rajonale për të zbatuar projekte ambicioze të Ma-

rrëveshjes së Gjelbër në terren.

Prioritetet e vitit 2023 të komisionit ENVE përfshijnë mbështetjen e vazhdueshme për të ofruar ambicien “Zero Ndotje” të BE-së dhe për finalizimin e instrumenteve konkrete për të përshpejtuar tranzicionin energjetik dhe për të përballuar krizën energjetike, siç parashikohet në paketën “Fit for 55” dhe në “REPowerEU”. Perspektivat afatmesme dhe afatgjata të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane, për sa i përket kuadrit të përgjithshëm, qeverisjes dhe mekanizmave të zbatimit, do të jenë gjithashtu në qendër

të vëmendjes në vitin 2023. Komisioni ENVE do të vazhdojë të punojë për të siguruar praninë e qyteteve dhe rajoneve në samitet e Kombeve të Bashkuara për klimën dhe biodiversitetin, si dhe nxitjen për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke u mbështetur në angazhimin e saj të fortë me Paktin e Kryetarëve të Bashkive dhe nisma të tjera përkatëse.

Frida Nilsson (SE/Rinovo), Anëtare e Komunës Linköping dhe Roby Biwer (LU/PES), anëtare e këshillit të qytetit Bettemburg, prezantuan arritjet kryesore të pjesëmarrjes së Korporatës në Konventën e Kombeve të Bashkuara për biodiversitetin - COP15 në Montreal, duke theksuar se Komiteti përmendet në mënyrë eksplicite në vendimin përfundimtar të COP15 si një partner kyç në mbështetjen e zbatimit të Planit të Veprimit për qeveritë nën kombëtare të Kornizës Globale të Biodiversitetit Kunming-Montreal. Sinergjimi i axhendave të klimës dhe biodiversitetit është një sfidë kryesore për Korporatën.

Hanna Zdanowska (PL/EPP) prezantoi pikat kryesore të projekt-opinionit të saj mbi ‘Ndryshimin e Direktivës për Asbestin’, i cili do të miratohet në seancën plenare të KR-së më

15-16 mars. Asbesti është një substancë shumë e rrezikshme, kancerogjene, e cila është ende e pranishme në shumë ndërtesa dhe është përgjegjës për shumë vdekje të shmangshme në BE.

Anëtarët debatuan për prioritetet e Presidencës suedeze për sigurinë energjetike dhe tranzicionin klimatik me Arvid Palmkvist, nga Përfaqësimi i Përherëshëm i Suedisë në BE dhe Sara Nelen, Zëvendës Shefja e Kabinetit të Zëvendës Presidentit Ekzekutiv të Komisionit Evropian Frans Timmermans.

Anëtarët patën një shkëmbim mendimesh mbi opinionin e Korporatës mbi ‘Rishikimin e legjislacionit të BE-së për cilësinë e ajrit të ambientit’ nga raportuesi Una POWER (IE/Greens), Këshilltar për Këshillin e Qarkut Dún Laoghaire Rathdown.

Takimi përfshiu një prezantim të Partneriteteve për Inovacion Rajonal dhe të Manualit Lokal të Marrëveshjes së Gjelbër mbi përshatjen klimatike, një paketë mjetesh interaktive që ofron informacion mbi ndihmën financiare dhe instrumentet teknike për të vendosur masat e përshatjes klimatike bazuar në zona të ndryshme gjeografike dhe specifika rajonale.

BEI, 824 milionë euro në Ballkanin Perëndimor në vitin 2022, të plotësuar me 11.2 milionë euro grante

EIB Global investoi 835.2 milionë euro në Ballkanin Perëndimor në vitin 2022 për projekte të reja, duke kontribuar në Planin Ekonomik dhe Investues të BE-së dhe duke synuar të mobilizojë afër 3.5 miliardë euro investime të reja në rajon. Këto investime do të përshpejtojnë tranzicionin e gjelbër dhe dixhital, do të promovojnë një integrim më të madh rajonal dhe do të mbështesin rrugën e anëtarësimit në BE të rajonit.

Nën krahun e saj të dedikuar për operacione jashtë Bashkimit Evropian - EIB Global rriti mbështetjen teknike për projektet e reja të efikasitetit të energjisë dhe energjisë së rinovueshme.

Që nga viti 2020, investimet e Bankës në rajon që mbështesin tranzicionin e qëndrueshëm të gjelbër dhe dixhital të ekonomive lokale arrijnë në 2.5 miliardë euro. Mbështetja për bizneset e vogla, krijimi i vendeve të punës dhe dekarbonizimi vazhdoi të jetë ndër prioritetet e Grupit EIB, si një partner kyç i sektorit privat.

Banka e BE-së, përmes krahut të saj të dedikuar për aktivitetet jashtë Bashkimit Evropian - EIB Global - investoi 824 milionë euro në të gjithë Ballkanin Perëndimor në vitin 2022 për të përshpejtuar lidhjen e qëndrueshme, mjedisin e pastër, tranzicionin e gjelbër, dixhitalizimin dhe rritjen e sektorit privat. Këto projekte kontribuojnë në nxjerrjen e Planit Ekonomik dhe të Investimeve të BE-së për rajonin dhe nismës Global Gateway të BE-së. Për më tepër, Banka mobilizoi 11.2 milionë euro në grante për të iniciuar projekte të qëndrueshme, të zhvillimit urban, eficiencës së energjisë dhe të energjisë së rinovueshme. Pjesa më e madhe e firmave të reja iu nda për transportin më të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas



nëpërmjet projekteve hekurudhore dhe ujore, duke arritur në 75% të totalit të kreditimit vitin e kaluar, e ndjekur nga investimet në bizneset e vogla, mbrojtjen e mjedisit dhe dixhitalizimin.

Si një nga lojtarët kryesorë të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), EIB Global zhvillon dhe zbaton investime në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian, institucionet financiare ndërkombëtare dhe ekonomitë e Ballkanit Perëndimor. Kjo qasje e Ekipit të Evropës maksimumizim përdorimin e financave të disponueshme për investime shumë të nevojshme. Banka e BE-së ka projektuar gjithashtu instrumente financiare novatore, duke

përfshirë një përzjerje huash, garancish, këshillimi dhe grantesh, nën Fondin Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm Plus (EFSD+), për të mbështetur bashkitë, prodhuesit e energjisë, korporatat, bizneset e vogla dhe bankat tregtare me investime. Në sektorët e energjisë, lidhjes dhe dixhitale.

Që nga viti 2020, BEI ka investuar 2.5 miliardë euro në Ballkanin Perëndimor duke ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë dhe konkrete për vendet, duke lehtësuar një zhvendosje afatgjatë drejt një ekonomie neutrale ndaj klimës, të sigurt nga energjia dhe gjithëpërfshirëse, duke trajtuar njëkohësisht pasojat më të menjëhershme të krizës.

“Tani, ne planifikojmë të zgjerojmë përfshirjen tonë në sektorin e energjisë duke kontribuar në paketën e mbështetjes energjetike të BE-së prej 1 miliardë eurosh të miratuar në dhjetor 2022, që përfshin projekte të energjisë së rinovueshme dhe ndërtimin dhe përmirësimin e rrjetit të energjisë dhe objekteve të ruajtjes”, - nënvizoi zëvendës presidenti Pavlova.

Fillimi i projekteve miqësore për klimën dhe zhvillimi urban

Si bankë e BE-së për klimën, mbi 80% e 824 milionë eurove të nënshkruara në vitin 2022 shkuan për projekte të qëndrueshme për mjedisin, duke kontribuar kështu drejtpërdrejt në veprimin e klimës.

Ndër të tjera, të ardhurat e huave do të mundësojnë ndërtimin e seksionit hekurudhor Beograd-Nish në Korridorin X në Serbi, rehabilitimin e pjesës së Kosovës të Rrugës Hekurudhore Evropiane 10 dhe përmirësimet të mëtejshme në portet dhe infrastrukturën ujore përgjatë lumenjve Sava dhe Danub.

Në Maqedoninë e Veriut, EIB Global do të sigurojë financim për infrastrukturën e furnizimit me ujë, ujërave të zeza dhe mbrojtjes nga përmbytjet në 80 komuna. Për të përshpejtuar dixhitalizimin, fonde shtesë janë ndarë për projektin e Shkollave të Lidhura në Serbi.

Krahas financimit të saj, Banka ka dhënë 11.2 milionë euro grante për përparimet dhe zbatimin e projekteve të reja. Në Bosnje dhe Hercegovinë,

asistenca teknike e EIB Global do të mundësojë ndërtimin e një ferme me erë 50 MW në rajonin e Travnikut, duke përshpejtuar kalimin drejt burimeve të rinovueshme dhe të sigurta të energjisë.

Në Shqipëri, Banka mbështet përparimet e një projekti strehimi social në kryeqytetin e vendit, si dhe zhvillimin e planeve të investimeve për qarqet Shkodër dhe Lezhë për të ndihmuar në përmirësimin e lidhjes, cilësisë së mjedisit dhe sektorit të turizmit.

Në Kosovë, EIB Global po ndihmon në përmirësimin e infrastrukturës dhe standardeve të arsimit të lartë.

Partner kyç i bizneseve të vogla në rajon

Kontributi në rimëkëmbjen, rritjen, krijimin e vendeve të punës dhe dekarbonizimin e sektorit privat vazhdoi të jetë fokusi i Grupit EIB në vitin 2022. Në bashkëpunim me institucionet kombëtare të zhvillimit dhe bankat tregtare, Banka siguroi 150 milionë euro në formën e linjave kreditore për bizneset e vogla për të ndihmuar ato adresojnë nevojat e tyre për likuiditet dhe investime, ndërkohë që kalojnë në një model më neutral ndaj klimës, gjithëpërfshirës dhe dixhital.

Këtë vit zyrtarisht u shfaq linja e kredisë për financimin e ndikimit të Bankës që nxit sipërmarrjen e grave dhe mundësitë gjithëpërfshirëse të punësimit në të gjithë rajonin. Nëpërmjet kësaj kredie, bankat partnere ofrojnë shpërblime financiare për kompanitë që angazhohen të punësojnë njerëz nga grupet sociale në nevojë në një bazë afatgjatë. Në përgjigje të krizës aktuale të energjisë, EIB Global krijoi një linjë krediti të dedikuar për projektet me efikasitet klimatik dhe energjetik.

2 mars 1444, Kuvendi i Lezhës bashkon shqiptarët

Kuvendi i Lezhës, me 2 mars 1444, është ngjarja më e rëndësishme në gjithë historinë e popullit shqiptar. Me vendimet që mori ky Kuvend i Madh si dhe me rrjedhjat historike që ai krijoi, me epopenë çerekshekullore, i vuri shqiptarët në llogoren e parë të luftës antiosmane për mbrojtjen e atdheut dhe Evropës kristiane nga barbari osman. Çlirimi i vendit me Kryengritjen e vitit 1443, ishte një fitore historike e Skënderbeut që duhej mbrojtur me çdo kusht. Perandorisë Osmane, fuqisë ushtarake më të madhe të kohës, Skënderbeu ia njihte mirë forcën dhe e dinte fort mirë, se nuk mund t'i bëhej ballë pa bashkimin e forcave të brendshme politike, ushtarake dhe ekonomike, si dhe pa bashkëpunimin me vendet e tjera. Për zgjidhjen e këtyre detyrave ai gjykoj mbajtjen e një kuvendi të përgjithshëm, ku të përfaqësoheshin të gjithë fisnikët e vendit dhe zhvilloi paraprakisht



takime me ta, si rrjedhojë e të cilave u vendos që të mbahej në Lezhë një kuvend i madh. Lezha kishte një pozitë gjeografike tepër të favorshme për mbajtjen e kuvendit. Ajo ndodhej në afërsi me zotërimet e pjesëmarrësve kryesorë të kuvendit, veçanërisht me ato të Dukagjinëve e Kastriotëve. Që me Gjonin, të atin e Skënderbeut, qendra e gravitetit të Kastriotëve, kishte kaluar në trevën bregdetare të Bregmatit, Fushë-Kuqes e Shufadajës, e cila si në veri, (në Lezhë) ashtu edhe në jug të saj (Durrës) kishte zotërimet e Venedikut në Shqipëri. Porti i Shufadajës, si dhe Kruja kryeqyteti, për Skënderbeun, krijuan një pozitë shumë të përshtatshme gjeopolitike për lidhjen me Perëndimin antiosman.

Edhe në të zgjedhurit e vendit, Skënderbeu veproi me po atë urtësi e maturi. Kështu, që të mos i linte përshtypjen se kujdesej më fort për nderin e vet, se të të tjerëve dhe që të mos mbetej asnjë shteg për dyshime, nuk i thirri princërit në Krujë. Por ai nuk i thirri as në Apoloni, as në Denjë, as në Zhabjak, apo në ndonjë qytet tjetër të Epirit, me qëllim që t' mos linte për të tjerët ndonjë arsye zilie apo bishtimi, sepse ka njerëz që gjërat e veta i ngrenë më shumë se të tjerëve; prandaj dhe ata, duke i çmuar vendet e veta jo më pak, por më tepër të denjat, me siguri që ose do të tërhiqeshin me zor në vendet e të tjerëve, ose nuk do të pranonin të vinin fare. Në një largësi prej pak më shumë se 22 000 hapash nga Kruja dhe ndërmjet kësaj e Shkodrës, ndodhet qyteti i Lissos, të cilin me një emër më të zakonshëm e quajnë Alessumin (Lezha). Këtu u pa e udhës që të bëhej mbledhje edhe për shkak se vendi ishte vetiu i përshtatshëm, edhe për arsye se ndodhej nën sundimin venedikas, që e pëlqenin dhe e kishin fort për zemër të gjithë princat.

Kuvendi i fisnikëve shqiptarë u mbajt, më 2 mars 1444, në Katedralen e Shën Nikollës në Lezhë.

Në të morën pjesë udhëheqës të kryengritjeve të mëparshme antiosmane, si dhe pjesëtarë të tjerë të aristokracisë shqiptare. Midis tyre ishin; Skënderbeu, Gjergj Arianiti, Andrea Topia (bashkë me dy djemtë, Kominin e Muzakën dhe të nipin

Tanushin), Gjergj Stres Balsha, Nikollë e Pal Dukagjini, Pjetër Spani (bashkë me katër djemtë, Aleksin, Bozhidarin, Vruoan dhe Mirkon), Lekë Zaharia, Teodor Muzaka i Riu (dhe pjesëtarë të tjerë të kësaj familjeje), Zahari Gropa, Lekë Dushmani me Pjetrin e fisnikë të tjerë fqinjë me ta, Stefan Gjurashi.

Vendimi më i rëndësishëm i Kuvendit të fisnikëve shqiptarë që u mor në Lezhë, më 2 mars 1444, nga kuvendarët, ishte bashkimi i shqiptarëve në formën e një besëlidhjeje politike ndërmjet zotëruesve të lirë dhe fisnikëve të tjerë të vendit, që u njoh me emrin Besëlidhja Shqiptare e Lezhës. Si kryetar i Lidhjes u zgjodh njëzëri me brohoritje Skënderbeu. Me t'i dhënë fund fjalës Skënderbeu, princërit të gjithë u drejtuan nga ai dhe duke ia miratuar një gojë dhe me zë të qartë mendimin, po e lavdëronin fort dhe po e ngrinin në qiell si shpëtimtarin e lirisë e të gjithë lavdisë. Dhe kështu, pasi ia lanë atij të gjithë me radhë e vullnet të lirë dhe ia kaluan gati si me dorë pushtetin, popujt, ushtritë dhe pasi ia besuan drejtimin suprem të të gjithë gjendjes e kujdesin e luftës, e zgjodhën kryetar e kapedan të tyre të vetëm.

Kuvendi i Lezhës, pasi zgjodhi



Katedralja e Shën Nikollës në Lezhë, Parlamenti i parë i shqiptarëve.

kryetarin e Lidhjes së Lezhës, Skënderbeun, vendosi që institucioni më i lartë të bëhej Kuvendi i Anëtarëve të Besëlidhjes, (Parlamenti i Shqiptarëve), i cili do të mbledhej herë pas here për çështje të rëndësishme të shtetit e të luftës. Kuvendi i princave shprehte bashkimin e shqiptarëve që u arrit në Lezhë. Një vendim tjetër shumë i rëndësishëm, që morën besëlidhësit e Lezhës, më 2 mars 1444, ishte krijimi i ushtrisë së përbashkët me komandant

të përgjithshëm Skënderbeun dhe atij iu ngarkua detyra e organizimit të luftës antiosmane, gjë që e kreu me sukses.

Në fillim forcat ushtarake të Besëlidhjes Shqiptare të Lezhës kishin karakter federal. Më vonë, me formimin e shtetit të bashkuar, u shkrinë në një ushtri unitare. Masa e luftëtarëve vinte kryesisht nga fshatarësia.

Ushtria shqiptare përbëhej nga trupa të përhershme me rrogë dhe luftëtarë vullnetarë që mobilizoheshin me në krye princat në kohë lufte. Trupat e përhershëm, stërviteshin dhe drejtoheshin nga Skënderbeu dhe përbënin 8000 forca aktive kalorës e këmbësorë. Në brezin anësor të mbrojtjes, për ruajtjen e kështjellave ishin 4000 forca tjera të përhershme nën komandën e Moisi Golemit.

Masën kryesore ushtarake e përbente ushtria vullnetare që mobilizohej në kohë lufte e komandohej nga fisnikët dhe arrinte në 30 000 luftëtarë, një ushtri e madhe kjo për kohën. Në ushtrinë shqiptare, Skënderbeu i jepte përparësi kalorësve që lëviznin me shpejtësi dhe këmbësorëve të armatosur lehtë. Në taktikë e strategji luftarake Skënderbeu u mbështet në traditën e popullit, luftë guerile, aksione të


befasishme si dhe ndeshje të hapura dhe luftë mbrojtëse në kështjella. Gjithnjë duke ia përshtatur madhësisë së forcave të armikut. Për këtë analisti i Sulltan Muratit, që pati shoqëruar Padishahun në rrethimin e parë të Krujës (1450), Dursun Beu, shkruante me urrejtje: "...Ata qafir të mallkuar, gjind të padukshëm të shejtanit, sulmonin nga malet e tyre të larta si rrufeja dhe u zbrapsnin si era, duke u zhdukur nëpër pyjet e kreshtat e pa arritshme."

së krishterë nga barbari osman.

Besëlidhja Shqiptare e Lezhës që u formua, me iniciativën e Skënderbeut, në Katedralen e Shën Nikollës në Lezhë mori vendime të mëdha. Ajo krijoi një arkë lufte për të mbajtur ushtrinë e përbashkët të Lidhjes, që do komandohej nga Skënderbeu. Me këto forca ushtarake komanda shqiptare me në krye Kastriotin, arriti të përballojë 25 beteja. Duke prapsur e thyer edhe forca kolosale të ushtrive perandorake të llogaritura në mbi 100 000 veta, të udhëhequra nga dy gjeneralët më të shquar të perandorisë osmane, sulltan Murati i Dytë dhe Mehmeti i Dytë, për rrethimin e Sfetigradit (1448) dhe të Krujës (1450, 1466, 1467).

Kuvendi i princave, që u bë më 2 mars 1444, shprehte bashkimin e shqiptarëve në një aleancë politiko-ushtarake, të cilën historianët e kanë quajtur Besëlidhja Shqiptare e Lezhës. Besëlidhja Shqiptare e Lezhës, përbente të parin bashkim të gjerë politik të

Një vendim tjetër, që Kuvendi i fisnikëve mori në Lezhë ishte krijimi i një arke të përbashkët pranë



Skënderbeut. Kjo arkë përbante kontributet vjetore të fisnikëve si dhe të ardhurat e tjera që do t'i shërbenin Skënderbeut për të përballuar shpenzimet për mbajtjen e ushtrisë, të armatimeve të saj si dhe për ndërtimin dhe fortifikimin e kështjellave. Fondet monetare kryesore të Arkës do të krijoheshin me ndihma në të holla nga secili anëtar i Besëlidhjes, sipas kuotave të caktuara nga Kuvendi i Lezhës. Të ardhura të mëdha siguroheshin nga kriporja e Shën Kollit, që e kishin Kastriotët (sipas Barletit) pranë grykëderdhjes së lumit Mat. Shuma të mëdha të ardhurash monetare erdhën nga kontributet e qyteteve italiane, ndihmat e Papës, të kishës e tregtarëve e fisnikëve evropianë, që e kishin pënder të derdhin e të kontribuonin për arkën e Skënderbeut për të forcuar luftën e shenjtë për mbrojtjen e Evropës

shqiptarëve. Kjo besëlidhje me një evolucion të brendshëm, të diktuar nga lufta me turqit, u kthye në një aparat shtetëror, në një shtet të përqendruar që kishte si bazë zotërimet e Kastriotëve. Kryengritja fitimtare e vitit 1443 dhe Kuvendi i Përgjithshëm Shqiptar i 2 marsit 1444 shënuan një kthesë vendimtare në luftën kundër pushtimit të huaj osman duke sanksionuar epopenë më të lavdishme në Historinë e Popullit Shqiptar, që historianët e kanë quajtur epoka Skënderbegiane. Kjo epokë, përbën ngjarjen më të rëndësishme e më kulmore të tërë historisë së popullit shqiptar, që la gjurmë të pashlyeshme në vetëdijen kombëtare të të gjithë shqiptarëve. Ajo u dha atyre traditën historike të luftës kundër pushtuesit osman dhe mbi këtë bazë ndjenjat e fuqishme kombëtare si dhe vetë ekzistencën e Kombit Shqiptar.

Agim Bedini, futbollist dhe trajner futbollit i UEFA-s

S kënderbegasi Agim Bedini, është një nga futbollistët me emër në ekipin e “Partizanit” dhe më pas trajner i certifikuar nga UEFA. Ai ka luajtur futboll me ekipet e sistemit zinxhir të Klubit Sportiv “Partizani”.

Agim Bedini ka mbaruar Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, Institutin e Lartë të Kulturës Fizike “Vojo Kushi” si dhe Kursin Pasuniversitar njëvjeçar për Futboll. Ka marrë kategorinë e dytë si trajner në vitin 1991 si trajner i “Partizanit”, ka marrë diplomën “UEFA-B” në vitin 2007, diplomën “UEFA-A” në vitin 2010, etj... Ka qenë trajner i skuadrës “Irodotos” në Kretë të Greqisë në vitet 1991-1993; trajner i “Asteras Peramos” po në Kretë; në vitet 1996-1997 trajner i parë i ekipit “Ergotelis”, i cili nga viti 2005 është pjesëmarrës në superligën greke; në vitet 1988-1989 trajner i “Olimpiakos Qersonisu” që arriti finalist në Kupës së Greqisë; në vitet 2004-2005 trajner i ekipit grek “Tibaqi” fitues i kampionatit të kategorisë së parë në rrethin e Iraklios; në vitin 2006-2007 drejtor teknik i ekipit të futbollit “Irodotos”, ndërsa në vitin 2007-2008 trajner i ekipit “Asteras Peramos” dhe së fundi, në vitin 2010-2011 trajner i “Minoiki” po në Greqi.

Gjatë kësaj periudhe, Agim Bedini, trajneri i njohur nga Shqipëria, bëri emër dhe mori vlerësime të shumta nga specialistët e drejtues të futbollit në ekipet që stërviti. Ndër ta po përmendim disa, përkatësisht dokumente greke me firmë e vulë të përkthyer shqip:

Shoqëria futbollistike-atletike “N. Alikarnasos”: “...Vërtetohet se Agim Bedini punoi si trajner i ekipit tonë ‘Irodotos’ nga 24.12 deri më 20.06.1992 me zell, përkushtim dhe pasion për punën, duke bërë që ekipi të dalë kampion në kategorinë e katërt të trupit të parë të kampionatit kombëtar të Greqisë, duke e ngritur në kategorinë e tretë kombëtare-profesionist. Trajneri i lartpërmendur tregoi cilësi të një mjeshtri në stërvitjen e futbollistëve, në gjendjen fizike, teknike dhe taktike të futbollit...”. (Firmosur nga kryetari Mihalis Stefanakis dhe sekretari i përgjithshëm Janis Skurellos).

Drejtesit e “Asteras Peramos” (Greqi): “...Trajneri Agim (Andrea) Bedini tregoi se njohuritë e tij në stërvitjen e futbollistëve kishin baza të një niveli shkencor. Marrëdhëniet e tij me klubin dhe futbollistët ishin të shkëlqyer. Për shkak të pasionit e dashurisë që tregoi për punën dhe futbollin u bë i dashur jo vetëm për publikun sportdashës...”. (Firma e titullarëve Jorgios Koskinas dhe Manolis Metaksaqis).

Drejtesit e klubit “Irodotos” (Greqi): “...Zoti Agim (Andrea) Bedini punoi si trajner pranë klubit tonë në sezonin 1955-1956. Me profesionalizmin e tij bëri që ta ngrejë ekipin në kategorinë e tretë profesionale. Kryesia e klubit, futbollistët dhe sportdashësit shprehim kënaqësinë dhe falënderimin tonë për punën e bërë nga zoti Bedini...”. (Titullarët J. Paterakis dhe J. Skurellos).

Drejtesit e klubit “Ergotelis”: “...



Agim (Andrea) Bedini ka qenë trajner i ekipit ‘Ergotelis’ në vitet 1996-1997. Puna dhe marrëdhëniet e tij me futbollistët dhe kryesinë e klubit kanë qenë shembullore...”. (Presidenti Sultatos Jorgjios).

Presidenti i Klubit të Futbollit ‘Olimpiakos Qersonisu’: “...Bedini ka qenë trajner i ekipit tonë në sezonin 1999-2000. Ky sezon qe për ekipin tonë më i miri i gjashtëdhjetëvjeçarit të fundit. Për arsye se ekipi ynë fitoi super-kupën e rrethit të Iraklios, por më e rëndësishmja ishte se ekipi u ngjiti në kategorinë e IV kombëtare. Ky rezultat u arrit së pari se ekipi përbëhej nga lojtarë shumë të mirë dhe së dyti, se kishte një trajner shumë të mirë, zotin Andrea Bedini që punoi shumë mirë dhe kishte një gjendje të shkëlqyer përgatitje të ekipit gjatë gjithë fazës. Trajneri është shumë punëtor, organizator dhe njohës i profesionit të tij!”. (Presidenti, Jorgjios Xagaraqis).

Drejtesit e klubit ‘Irodotos’: “...Bedini drejtoi ekipin në periudhën qershor 2001-janar 2003 si trajner... Gjithashtu dhe gjatë vitit 2001-2002, ku ekipi fitoi kampionatin dhe kupën e rrethit të Iraklios. Trajneri kishte marrëdhënie të shkëlqyer me drejtuesit e klubit dhe futbollistët...”. (Kryetari Serkis Antonis/ Sekretari, Skurellos Janis).

Agim Bedini lindi në Tiranë më 22.09.1954. Ai rrjedh nga një familje e njohur vlonjate, përkatësisht nga Kanina.

Gjyshi i tij, Muhamet Bedini njihet për aktivitetin e tij patriotik që nga viti 1890 e në vazhdim, deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë në vitin 1944.

Ai ka marrë pjesë në të gjitha luftërat kundër pushtuesve të vendit. Ka qenë gjithashtu dhe në grupin e afërt të sigurimit të Ismail Qemalit në shpalljen e Pavarësisë më 1912. Ka qenë një nga drejtuesit e Luftës së Vlorës në vitin 1920 dhe ka qenë pjesë e grupit që ka qëlluar me top Ahmet Zogun në qershor të vitit 1924. Topi, ishte marrë si trofe lufte italianëve në vitin 1920. Që nga fundi i vitit 1890 e deri në vitet 1945-1950, ai ka qenë dhe anëtar i gjykatës së lartë për dënimet e krimeve të luftës për qarkun e Vlorës. Muhameti ishte një nga anëtarët e rezistencës kundër pushtimit fashist në vitin 1939 dhe në vazhdim, një nga drejtuesit e luftës Nacional-Çlirimtare në Vlorë. Për këtë aktivitet patriotik është dekoruar me urdhra e medalje të shumta zyrtare. Muhamet Bedini, pas vdekjes është shpallur patriot dhe në shtëpinë e tij është vendosur një pllakatë përkujtimore. Sulo Bedini, babai i Agimit ka qenë partizan i Brigadës V-të Sulmuese që nga krijimi i saj si dhe ka marrë pjesë në formacionet partizane në ish-Jugosllavi deri në vitin 1945. Pas luftës ai caktohet në Divizionin e Mbrotjes së Popullit dhe më pas, është një ndër funksionarët e Sigurimit të Shtetit të sapokrijuar. Është cilësuar si një nga heronjtë e heshtur të Sigurimit të Shtetit, ka qenë ndër 5 anëtarët e grupit mbështetës të “Heroit të Popullit” Pal Mëlyshi dhe ka marrë pjesë aktive deri në eliminimin e plotë të grupeve armiqësore diversioniste që synonin rrëzimin e pushtetit popullor. Ai është një ndër pjesëmarrësit aktiv në radiollogjen e famshme “Liqeni i Vajkalit”, ku 6

vite me radhë, Sigurimi i Shtetit realizoi me sukses (1949-1955) këtë lojë. Për këto merita, ai është dekoruar me shumë medalje dhe urdhra të veçantë. Sulo Bedini vdes aksidentalisht në vitin 1956, duke lënë Agimin 2 vjeç dhe të vëllain, Nexhipin, i cili lindi dy javë pas vdekjes së të atit.

Në këtë familje, më 22.09.1954, lindi Agim Bedini. Shkollën 8-vjeçare e kreu në Tiranë, duke u aktivizuar dhe në ekipet e moshave të klubit “Partizani”. Pas një seleksionimi, në vitin 1968, falë talentit, përzgjidhet dhe merret nga ekipi i të rinjve të këtij ekipi. Aty është nën përkujdesjen e mjeshtrit të futbollit shqiptar, pedagogut të njohur të shumë brezave sportistësh, një nga ikonat e sportit shqiptar, Bejkush Birçen. Bejkushi, duke vlerësuar talentet, propozon që Agimi, së bashku me Vasil Sotirin dhe Luan Çekiçin, të vazhdonin studimet në shkollën “Skënderbej”, shkollë elitare në Shqipëri si dhe një vater e rëndësishme që ka nxjerrë sportistë kampionë e rekordmenë. Pra, paralel me mësimet, Agimi është dhe sportist i të rinjve të “Partizanit”.

“Gjatë katër viteve të shkollës ‘Skënderbej’, si shkolla e vetme elitare në Shqipëri ato vite, ruaj kujtime të shumta e nga më të bukurat, duke filluar nga komandanti i kompanisë Ismet Varfi, kujdestari Xhezo Lezo, mësuesit Bejkush Birçe, Flutura Xoxe, Isak Mezini e deri tek Sherif Çiçiku, i cili përveçse shofer i shkëlqyer, ishte dhe një trajner shumë i mirë. Por të paharruar ngelen dhe figurat e komandantit të shkollës Meço Starja e komisarit Agim Tepelena”, - kujton pas dekadash Agimi.

Gjatë këtyre viteve, sipas statistikave zyrtare të kohës e kujtimeve të bashkëkohësve, Agimi qe një futbollist i shkëlqyer i ekipit të të rinjve dhe i ekipit “Shpresa” të “Partizanit”.

Në një rast, në një ndeshje të kampionatit me ekipin “Shpresa”, trajneri i së cilës ishte i nderuari Miço Ndini, Agimi ka luajtur me katër qepje në kërcirin e këmbës, pa i treguar trajnerit. Pas ndeshjes, e shtruan me urgjencë në spitalin ushtarak, pasi i plasi hemorragjia. Gjatë këtyre viteve, ai luajti me bashkëlojtarë që lanë emër në futbollin tonë si Agim Murati, Luftar Guri, Astrit Xhakolli, Zini Hida, Fatmir Gjata, Arjan Shore e më vonë Artur Lekbello. “Nuk mund të harroj shokët e fëmijërisë të cilët fatkeqësisht nuk jetojnë më si Robert Kapo, Shpëtim Guzhita, Vasil Sotiri, me të cilët stërviteshim së bashku me orë të tëra në palestrën moderne të kohës që kishte shkolla”, - shton Agimi. Për sa i përket futbollit, ndër të tjera Agim Bedini shton: “Pas përfundimit të stazhit të shkollës ‘Skënderbej’ në 1973-1974, të cilin e zhvilluam pranë Batalionit të Sigurimit në Tiranë, afrohem pranë

klubit ‘Dinamo’. Në vitet 1974-1975 stërvitem pranë ‘Partizanit’. Gjatë shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, ku komandant kishim Jorgji Çamin, ne përfaqësuesja në futboll, ishim absolut. Në këtë shkollë unë dua të kujtoj me respekt pedagogët e përgatitjes fizike Petrit Murzaku, Suvorov Nikolla, Ruzhdi Kola, Tomorr Shehu, komandantin e shkollës Rustem Peçin, i cili ishte përkrahës dhe dashamirës i futbollit duke na krijuar të gjitha kushtet ideale për t’u stërvitur. Për nostalgjia më e madhe është për shokët e togës së Zbulimit; nga i paharruari Aqif Speci, Luftar Guri, Agim Bajrami, Besnik Bozo, shokët e ekipit në futboll Arjan Shore, Lulzim Meçi, Fatmir Gjata si dhe kundërshtarit tim në futboll, Memo Çelën, i cili me gjithë ambicien, asnjëherë nuk arriti të fitonte një ndeshje në tre vite. Aq i madh ishte ky hidhërim i Memos, sa ‘përtonte’ të më fliste dhe me gojë. Por fati e solli që pas shkollës të punonim bashkë me Memon në repartin e zbulimit në Marikaj... Aty, Memos i kishte dalë inati... Pas takimit dhe bashkëpunimit në Batalionin e Zbulimit në Marikaj të Vorës, ne e konsiderojmë njeri-tjetrin jo vetëm si shokë, por dhe si vëllezër. Kjo marrëdhënie është formuar dhe ka ardhur vazhdimisht në rritje. Deri në vitin 1986 unë luajta futboll me ekipin ‘Dajti’, ku lashë dhe fushën si futbollist. Në nëntor të vitit 1986 fillova si trajner me moshat e ‘Partizanit’, më vonë me të rinjtë dhe në vitet 1990-1991, trajner i ekipit ‘Shpresa’ të ‘Partizanit’, me të cilin u shpallëm dhe kampion kombëtar. Nga ky brez futbollistësh që stërvita, dolën futbollistë të talentuar që shkëlqyen në Shqipëri e jashtë saj si Nallbani, Tare, Murati, Jupii, Kola, Tafaj, Berisha, Thaçi, Sheta, Fejzollli, Satka, Zela e shumë të tjerë, që jo pak luajtën me ekipe të Italisë, Greqisë, Gjermanisë etj... Në këtë kuadër, dhe mua mu dha mundësia të punoja trajner futbollit në Greqi për 20 vite, duke arritur rezultate mbresëlënëse. Kriza greke, së fundi më solli në atdhe. Në vitet 2012-2013 punova si trajner i ekipit të Sarandës, ku arritëm rezultate të mira, duke rrahur në Tiranë dhe ‘Partizanin’ 3:0. Në vitin 2013-2014 punova si trajner i ‘Albpetrolit’ të Fierit, ku veçoj fitoren 1:0 kundër Tiranës në Tiranë në ndeshjet e Kupës së Republikës, gjë e cila solli dhe shkakimin e trajnerit Nevil Dede. Në vitin 2014 titullohem oficer i Ministrisë së Brendshme në Gardën e Republikës, ku paralel, në 2014 jam dhe trajner i ekipit ‘Tirana-Internacional (Pezë-Helmës) që nga kategoria e tretë u ngjiti në të dytën...”, - pohon Agim Bedini.

Maksim Fejzullahu
Kujtim Borici



<https://www.mod.gov.al/rekrutim>

M

e propozim të Ministrisë së Mbrojtjes, qeveria shqiptare ka vendosur rritjen në masën 7% të pagës bazë, sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armato-

sura. Kjo shënon rritjen më të madhe të pagave të ushtarakëve, të cilët një vit më parë morën një tjetër shtesë page për të gjitha kategoritë në masën 30%, të cilën e përfitojnë 6654 ushtarakë.

Aktualisht Ministria e Mbrojtjes ka nisur fushatën e rekrutimeve për 400 pozicione të lira pranë FA-së, si ushtarë apo detar aktiv. Kjo thirrje është e hapur për të gjithë të rinjtë e moshave 18-27 vjeç me arsim 9-vjeçar, të mesëm apo të lartë. Ndër përfitimet që marrin të gjithë ata që zgjedhin të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura janë:

- Puna e garantuar në FARSH dhe mundësi për karrierë të suksesshme, të ardhura mujore dinjitoze, si asnjëherë më parë për FA-të;
- Shërbim shëndetësor për vete dhe familjarët dhe mundësi kurimi të specializuar brenda dhe jashtë vendit;
- Sigurim shoqëror dhe përfitime suplementare pas

përfundimit të karrierës;

- Mundësi arsimimi dhe kualifikimi ushtarak brenda dhe jashtë vendit pa pagesë;
- Përparim në gradë dhe karrierë;
- Përgatitje fizike sipas standardeve të NATO-s;
- Angazhim në misione paqeruajtëse në kuadrin e NATO-s, OKB-së dhe BE-së, me përfitime financiare të konsiderueshme;

Po ashtu, për çdo të ri që bëhet pjesë e FA-së ofrohen trajnime dhe stërvitje jashtë vendit së bashku me kolegë të tjerë të NATO-s dhe SHBA-së, lehtësira për qira banese, transferim bashkëshorti/e, trajtim me ushqim, pagesë transporti si dhe kredi me norma të lehtësuara për banesën e parë të familjeve ushtarake.

Me rritjen e fundit të pagave, një oficer (grada e parë për ushtarakët oficerë të titulluar nëntoger), pas kryerjes së studimeve në Akademinë e Forcave të Armatosura, merr një pagë mbi 77 mijë lekë, pa përfshirë shtesat mbi pagë për kompensim ushqimor, shtesat për natyra të veçanta apo trajtimin me uniformë ushtarake, sportive, etj.

Regjistrohu në linkun më poshtë dhe personeli i rekrutimit në të gjithë vendin do ju kontaktojë <https://www.mod.gov.al/rekrutim>